

ANALIZA

Libri dëgjohet

NGA EDISON YPI

► FAQE 14

BLOG / PERIFERI

A do të largojnë Rudina e Glauku enveristët e fundit nga PD?

NGA ALBA MALLTEZI

► FAQE 14

EKSKLUZIVE / JA HISTORIA E PALLATIT QË PËRMENDI META

SI META E KRYEMADHI FITUAN 1 MILIONE EURO NGA 5 MILIONE LEKE

Pasuria e Presidentit dhe kryetares së LSI nga viti 2003 deri në vitin 2018. Si e bënë vilën në Gjirin e Lalzit dhe pallatin në Tiranë. Kryemadhi shet 10 apartamente me vlerë 890 mijë euro. Ilir Meta bleu vilë 60 mijë USD dhe e shiti 300 mijë euro

ADRIATIK DOÇI

► FAQE 2-3

[SHQIPTARJA.

ÇMIMI 30 LEKË

VITI IX - NR. 156 (2679)

E ENJTE, 04-07-2019

www.shqiptarja.com



SULMI I PRESIDENTIT

Soreca-Metës: Kushtetuesja dhe SPAK-u duhet të fillojnë punën

Reagon Meta, 10 pyetje ambasadorit të BE: Pse s'më mbështetët për dialogun?

VENDIMI I PRITSHËM

KE rrëzon kërkesën e Holandës për kthimin e vizave për Shqipërinë

► FAQE 8



INTERVISTA

Pasardhësi i Skënderbeut: Ju tregoj jetën e famijes sime në Itali

Kush është Loris Castriota Skanderbegh, famija e të cilit rrjedh nga djali i heroit kombëtar

► FAQE 16

NGA SELENE SCINICARIELLO

OPOZITA NE KAOS


KRYEBASHKIAKET E PD KUNDER BASHES: ZGJEDHJE ME 13 TETOR



Kryetarët e Bashkive të djathta kundërshtojnë linjën e kreut të partisë për bojkot të zgjedhjeve të kushtëzuar me largimin e Ramës, duke paralajmëruar se po përgatiten për zgjedhje të reja sipas dekretit të Presidentit. Mziu: Nuk ka lidhje Basha, por ligji e vota popullore. Kapllanaj: Gati për zgjedhje më 13 tetor

OPOZITA RIFILLON PROTESTAT, ME 8 KORRIK TUBIMI I RADHES

► FAQE 6



VENDIMI I QEVERISË

NDRYSHIMET, RREGULLAT E REJA PER KREDITE ME INTERES TE ULET

Qeveria vendosi dje masën e subvencionit, kush e merr dhe sa përfitojnë familjet që marrin banesë me kosto të lirë me ndihmë nga shteti

► FAQE 11

Pasuria e Presidentit

Ilir Meta bleu vilë 60 mijë USD dhe e shiti 300 mijë €

Pasuria e Metës dhe Kryemadhit nga viti 2003 deri në vitin 2018, si e krijuan vilën, pallatin dhe 13 apartamente me vetëm dy rroga

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Shqiptarja.com publikon pasurinë e plotë të deklaruar nga Presidenti Ilir Meta dhe kryetarja e LSI Monika Kryemadhi (çift bashkëshortësh) nga viti 2003 deri në vitin 2018 si dhe mekanizimin e krijimit të pasurive të paluajtshme dhe llogarive bankare. Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, Ilir Meta deklaroi blerjen e një vile në Golem me vlerë 60 000 dollarë. Vila ka edhe një lulishte 327 m². Për blerjen e vilës Ilir Meta ka marrë një kredi në bankën Italo-Shqiptare me vlerë 60 mijë dollarë. Çfarë ndodh më pas dhe si e shton pasurinë Ilir Meta? Tre vjet më vonë, pra në vitin 2006, vilën me vlerë 60 mijë USD, Meta e shet për 300 mijë euro. Më këtë lëvizje Meta fiton me rreth 250 mijë euro, ndër-

kohë që, gjatë kësaj kohë, nuk deklaroi asnjë investim në vilën e tij që të justifikojë rritjen e vlerës. Mbetet mister se si Meta e ka justifikuar rritjen e vlerës së vilës me

250 mijë euro, a është hetuar nga ILDKP ky rast dhe në çfarë përfundimi ka dalë. Katër vite më vonë, në vitin 2010, Ilir Meta deklaroi blerjen e një apartamenti në Rr. Barrikada

Tiranë me sipërfaqe 200 m² dhe më vlerë 400 mijë euro. Për justifikimin e blerjes së apartamentit, Meta deklaroi se ka marrë një kredi 200 mijë euro tek Credins Bank si

dhe 200 mijë euro i ka pasur cash, shumë e lartë kjo për t'u mbajtur jashtë sistemit bankar. Në vitin 2018 Meta nuk rezultoi të ketë detyrime për shlyerjen e kësaj kredie 200 mijë euro. Po gjatë këtij viti, pra në 2010, kur Meta ishte pjesë e qeverisjes së Sali Berishës, ka blerë vilën në Gjirin e Lalzit. Ai e deklaroi vilën me dy kate dhe me sipërfaqe 317 metra katrorë. Meta nuk deklaroi se sa është vlera e vilës, por thotë se këtë pasuri të paluajtshme e ka përfutur nga këmbimi me sipërfaqe ndërtimore 300 metra katrorë, ambiente tregtare, sipas kontratës me kompaninë Agi-Kons shpk, si përfutur me 33 % të sipërfaqes së ndërtimit si pronar truall. Gjithashtu nuk specifikohet se sa është vlera e ambienteve të shkëmbyera për të përfutur vilën. Bëhet fjalë për pallatin e Monika Kryemadhit, të cilit iu referua Meta ditën martë, ku sulmoi faktorin ndërkombëtar dhe kryeministrin Edi Rama, duke i akuzuar për komplot. Nga viti 2010 deri në vitin 2014, Meta dhe Kryemadhi nuk

deklarojnë lëvizje në pasuritë e paluajtshme. Nga viti 2014 deri në vitin 2018, shitblerja e pasurive të paluajtshme bëhet nga Monika Kryemadhi.

TË ARDHURAT DHE PASURIA FILLESTARE

Të ardhurat e ligjshme të deklaruara nga Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi janë vetëm dy paga, kryesisht të larta, pasi Meta ka mbajtur poste të larta shtetërore që nga ministër, zëvendëskryeministër, kryeministër, kryetar Kuvendi dhe së fundmi President. Gjithsesi, të ardhurat e tyre nuk e mbulojnë vlerën e pasurive të paluajtshme. Për këtë arsye, çifti Meta-Kryemadhi kanë marrë kredi në vlera të larta, kanë blerë lirë dhe kanë shitur shtrenjtë, u kanë falur tokë si dhe kanë dhënë tokë për të ndërtuar pallat. Pasuria fillestare e Ilir Metës ku ka hyrë në politikë është vetëm, një apartament banimi 2+1, në Rr. Qemal Stafa Tiranë, si dhe 1/3 e një parlamenti me sipërfaqe 99.5 m², përfutur me privatizim nga Monika Kryemadhi, pa vlerë të specifikuar.

PASURIA E ILIR METËS DHE MONIKA KRYEMADHIT NDËR VITE

VITI 2003
Apartament banimi 2+1, Rr. Qemal Stafa
Vilë në Golem, 60 000 dollarë, lulishte 327 m ² .
Hua në bankën Italo-Shqiptare 60 000 dollarë
Shlyerje kredie, 7 580 dollarë në bankën Italo-Shqiptare
Interesa bankare 2 160 dollar, banka Italo-Shqiptare
VITI 2004
Apartament banimi 2+1, Rr. Qemal Stafa, deklarim i mëparshëm
Vilë në Golem, 60 000 dollarë, lulishte 327 m ² , deklarim i mëparshëm
Shlyerje kredie për vilën në Golem, 19 808 dollar
Paga nga si anëtar i Kuvendit të Shqipërisë, 1. 735 404 lekë.
VITI 2005
Paga dhe shpërblime në Kuvendin e Shqipërisë, 1 423 787 lekë
Paga dhe shpërblime të bashkëshortes në Kuvendin e Shqipërisë, 1 672 861
Shlyerje kredie për vilën në Golem, 9 770 dollarë
VITI 2006
300 000 euro, shitje e vilës në Golem
1 386 694 lekë, paga nga pjesëmarrja në komisione dhe nga Kuvendi i Shqipërisë.
900 000 lekë, pagë e bashkëshortes nga sigurimet kalimtare.
8 840 dollar, shlyerje kredie në bankën Italo-Shqiptare
VITI 2007
Tokë me sipërfaqe 1200 m ² , vlerë 5 000 000 lekë, ku 700 m ² janë blerë me të ardhurat e veta në vitin 2007, ndërsa pjesa tjetër është përfutur me dhurim në vitin 1995 nga i vëllai.
1 425 167 lekë, paga shpërblime dhe komisione
1 000 919, pagë bashkëshortja në këshillin bashkiak
11 750 dollar, shumë e kthyer nga kredia e marrë pranë bankës Italo-Shqiptare
21 124 dollar, shuma e mbetur pa shlyer pranë bankës Italo-Shqiptare
VITI 2008
43 256 lekë llogari për pagat në Credins Bank
4 807 dollarë llogari bankare për shlyerje kredie në San Paolo Bank
2 777 566 lekë paga dhe shpërblime si deputet në Kuvendin e Shqipërisë
659 565 lekë të ardhura nga bashkëshortja si ish-deputete në Kuvendin e Shqipërisë
378 789 lekë të ardhura nga bashkëshortja si anëtare e Këshillit Bashkiak Tiranë

22 000 dollarë shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm për kredinë e marrë për blerjen e një apartamenti banimi në Durrës
40 000 lekë shtesë në llogarinë bankare të bashkëshortes Monika Kryemadhi
Kontratë sipërmarrje në emrin e Monika Kryemadhit mbi truallin e deklaruar më parë, në rrugën "Teodor Keko", mbrapa Doganës së Tiranës, me firmën "Agikons", nga e cila përfiton 35% të sipërfaqes së ndërtimit
VITI 2009
161 808 lekë borxh në llogarinë bankare për pagat te Credins Bank
34 727 lekë, gjendje në llogarinë bankare për pagat panë Credins Bank
1 388 euro në llogarinë bankare në Credins Bank
20.321 euro overdraft, panë bankës Credins, me garant Drini Kryemadhi
VITI 2010
Shtesë në llogarinë Bankare Credins Bank 135 318 lekë
Apartament banimi 200 metra katrorë te Rr. Barrikada 400 000 euro
Burimi, kredi nga Credins Bank 200 000 euro
Gjendja cash 200 000 euro
Paga si zëvendëskryeministër dhe ministër Ekonomie 1 768 385 lekë
Bashkëshortja, sekretare e LSI 969 324 lekë
Anëtare e Këshillit Bashkiak 278 100 lekë
Kredi nga Credins Bank për blerja apartamenti 200 000 euro, 6550 euro paguar
Shtesë në llogarinë Bankare tek Credins Bank, 295 782 lekë
Pakësim në llogarinë Bankare tek Credins Bank
Apartament banimi 2 kate, me sipërfaqe 317 metra katrorë në fshatin turistik në Gjirin e Lalzit Durrës me kontratë sipërmarrjeje me Lura sh.p.k.
Burimi, këmbimi me sipërfaqe ndërtimore 300 metra katrorë, ambiente tregtare, sipas kontratës me kompaninë Agi-Kons shpk, si përfutur 33 % të sipërfaqes së ndërtimit si pronar truall.
VITI 2011
Ilir Meta deklaroi se gjatë vitit 2011 ka përfutur vetëm nga paga e tij si deputet dhe e Monikës si sekretare organizative e LSI-së
VITI 2013
Kryemadhi të ardhura nga LSI, 663 897 lekë.
Të ardhura si deputete 714 099 lekë.
Meta, të ardhura si deputet 1 839 073 lekë.
Të Ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka
Gjendja cash 11 000 euro.
Detyrim overdrafti 95 093 lekë.

VITI 2014
Kryemadhi paga si deputete, 2 295 826 lekë.
Meta të ardhura si deputet, 1 964 421 lekë.
Pronare me 100 % e 13 apartamenteve të banimit me sipërfaqe totale 1444.8 m ² .
Të ardhura nga shitja e ap. të banimit, 57 798 euro.
Të ardhura nga shitja e ap. të banimit, 64 020 euro.
Gjendja e llogarisë bankare, 56 778 euro.
Gjendja e llogarisë, 2 336 669 lekë.
Gjendja cash, pakësuar me 8 000 euro.
Gjendja e llogarisë, 11 038 euro.
Gjendja e llogarisë bankare, 82 086 lekë.
Kredi bankare, detyrimi 163 506 euro.
Meta, gjendja e llogarisë, shtuar me 269 524 lekë.
Shpenzime për përvjetorin e ditëlindjes, 1 822 400 lekë.
Shpenzime për energjinë elektrike 338 640 lekë.
VITI 2015
Paga deputete, 2 629 956 lekë.
Interesa bankare, 14 609 lekë.
Vajza, interesa bankare, 182 euro.



Pasuria e Presidentit

Ja si Meta-Kryemadhi fituan 1 milionë euro nga 5 milionë lekë

Zbulohet skema se si Meta dhe Kryemadhi u bënë me pallat në Tiranë dhe me vilën Luksoze në Gjirin e Lalzit, kryetarja e LSI shet 10 apartamente me vlerë 890 mijë €

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Presidenti Ilir Meta deklaroi ditën e martë se bashkëshortja e tij i ka siguruar fëmijët pasi ka në pronësi një pallat. Po si arriti Kryemadhi të ndërtonte një pallat me të ardhura bazë vetëm pagën? Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi kanë përfituar pallatin në Tiranë dhe vilën në Gjirin e Lalzit me një sipërfaqe toke të blerë 5 milionë lekë dhe një pjesë të dhuruar nga vëllai i Kryemadhit. Konkretisht, në vitin 2007, Monika Kryemadhi deklaroi se ka blerë 1200 m² tokë, me vlerë 5 000 000 lekë, ku 700 m² janë blerë me të ardhurat e veta në vitin 2007, ndërsa pjesa tjetër është përfituar me dhurim në vitin 1995 nga i vëllai i saj. Një vit më vonë, pra në vitin 2008, Kryemadhi lidh një kontratë sipërmarrje me kompaninë Agi-Kons shpk, pa vlerë të specifikuar, për ndërtimin e një pallati në tokën me sipërfaqe 1900 m². Sipas kontratës së deklaruar, Kryemadhi do të përfitonte 35 % për qind të pallatit. Në vitin 2010, Meta dhe Kryemadhi, blejnë apartament banimi 2 kate, me sipërfaqe 317 metra katror në fshatin turistik në Gjirin e Lalzit Durrës me kontratë sipërmarrjeje me Lura sh.p.k, e njohur ndryshe si vila në Gjirin e Lalzit. Për të përfituar vilën, Meta dhe Kryemadhi thonë se kanë këmbyer sipërfaqen ndërtimore 300 metra katrore, ambiente tregtare,

sipas kontratës me kompaninë Agi-Kons shpk, si përfitues 33 % (më parë 35 %) të sipërfaqes së ndërtimit si pronar truall. Pra, nga toka që Kryemadhi ka dhënë për pallat, është përfituar pjesë në pallat dhe vila në Gjirin e Lalzit. Çfarë

ndodh më tej? Në vitin 2014, Monika Kryemadhi deklaroi se është pronare me 100 % e 13 apartamenteve të banimit me sipërfaqe totale 1444.8 m², në pallatin në fjalë. Nga viti 2014 dhe në vijim Kryemadhi nis shitjen e apartamenteve.

SHITJA E APARTAMENTEVE

Që nga viti 2014 deri në vitin 2018, kryetarja e LSI Monika Kryemadhi ka shitur 10 apartamente me vlerë 890 mijë euro. Në vitin 2014, Kryemadhi ka shitur dy apartamente me vlerë

57 798 euro dhe 64 020 euro. Gjatë vitit 2016, Kryemadhi ka shitur katër apartamente, konkretisht me sipërfaqe 200 m² në vlerën 345 000 euro, 104.74 m² në vlerën 60 958 euro, 166.2 m² në vlerën 85 088 euro dhe 108.5 m² në vlerën 57 885 euro. Gjatë vitit 2017, Kryemadhi ka shitur dy apartamente të tjera, konkretisht apartament me sipërfaqe 101 m² në vlerën 55 550 euro dhe apartament me sipërfaqe 166.2 m² në vlerën 58 806 euro. Gjatë vitit 2018, Monika Kryemadhi ka shitur edhe dy apartamente me sipërfaqe 76.99 m² me vlerë 42 284 euro dhe sipërfaqe 133.7 m² me vlerë 64 103 euro. Po gjatë këtij viti, Kryemadhi deklaroi një pagesë në vlerën 145 mijë euro për likuidimin e kështit të dytë të një kontrate, por nuk specifikohet lloji i saj.



Përfitimi

Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi kanë përfituar pallatin në Tiranë dhe vilën në Gjirin e Lalzit me një sipërfaqe toke të blerë 5 milionë lekë dhe një pjesë të dhuruar nga vëllai i Kryemadhit.

Lëvizja

Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, Ilir Meta deklaroi blerjen e një vile në Golem me vlerë 60 000 dollarë. Tre vjet më vonë, pra në vitin 2006, Vilën me vlerë 60 mijë USD, Meta e shet për 300 mijë euro.

Të ardhurat

Të ardhurat e ligjshme të deklaruara nga Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi janë vetëm dy paga. Të ardhurat e tyre nuk e mbulojnë vlerën e pasurive të paluajtshme. Për këtë arsye, ata kanë marrë kredi në vlera të larta, kanë blerë lirë dhe kanë shitur shtrenjtë etj.

Apartamentet

Që nga viti 2014 deri në vitin 2018, kryetarja e LSI Monika Kryemadhi ka shitur 10 apartamente me vlerë 890 mijë euro. Kryemadhi ka deklaruar në vitin 2014, 13 apartamente.

Meta, të ardhura nga paga, 2 015 182 lekë.
Gjendja e llogarisë, pakësuar me 12 175 euro.
Gjendja e llogarisë, shtuar me 14 609 lekë
Vajza, gjendja, shtuar me 182 euro.
Gjendja e llogarisë, pakësuar me 35 915 lekë.
Detyrime të papaguara në vlerën 154 207 euro për një kredi bankare për blerje apartamenti.
Detyrime të papaguara në vlerën 1 235 677 lekë për overdraft bankar.
Meta, gjendja e llogarisë 1 815 082 lekë.
VITI 2016
Të ardhura si deputete, 1 993 076 lekë.
Meta të ardhura si kryetar Kuvendi Kuvend, 1 955 743 lekë
Shitur ap. banimi me sip. 104.74 m ² , në vlerën 60 958 euro
Shitur ap. banimi me sip. 166.2 m ² , në vlerën 85 088 euro
Shitur ap. banimi me sip. 108.5 m ² , në vlerën 57 885 euro
Shitur ap. banimi me sip. 200 m ² , në vlerën 345 000 euro
Gjendje llogari dyemërore, së bashku me vajzën Bora, shtuar me 9 181 lekë.
Gjendje llogari bankare, shtuar me 174 403 euro.
Mbyllur kredia në vlerën 155 000 euro më 25.02.2016 pasi është zëvendësuar debitori.

Pakësuar gjendja në e z. Meta me 1 113 620 lekë.
Çelur llogari bankare studentore për djalin, vlera 43 727 lekë.
Meta llogari dy emërore 1 001 029 lekë.
Shlyer 1 327 056 lekë për overdraft të marrë në vitin 2015.
VITI 2017
Të ardhura nga Kuvendi, shuma 1 993 386 lekë.
Metaj, të ardhura në Presidencë, shuma 982 830 lekë.
Shitur apartament banimi me sip. 101 m ² në vlerën 55 550 euro.
Shitur apartament banimi me sip. 166.2 m ² në vlerën 58 806 euro.
Gjendja e llogarisë bankare në emër të vajzës, shtesë 8 037 lekë.
Gjendja e llogarisë, pakësim 131 053 euro.
Gjendja e llogarisë bankare në Credins Bank, 140 000 GBP, (paund), për pagesë për shkollën për vajzën Znj. Bora Metaj dhe djalin, Z. Besar Metaj.
Djali, Z. Besar Metaj, overdraft, 264 239 lekë.
Meta, gjendja e llogarisë, pakësim 538 824 lekë.
Gjendja e llogarisë, shtesë 1 702 lekë.
Meta, overdraft, 106 954 lekë.
Bora Metaj, gjendja e llogarisë bankare, shtesë 71 euro.
Vajza Bora overdraft, 210 208 lekë
VITI 2018
Ilir Meta shtim i llogarisë, 1 319 680 lekë.
Llogari dyemërore, shtuar me 28 4009 lekë.

Paga si President, 2 550 183 lekë.
Dieta jashtë vendit, 6 480 lekë dhe 2 340 USD.
Të ardhura si kryetar KLD, 85 000 lekë.
Honorare nga mbledhjet e KLD, 42 500 lekë.
Overdraft, 133 845 lekë.
Monika Kryemadhi, shitje apartamenti 76.88 m ² , 42 284 euro.
Shitje apartamenti 133.7 m ² , 64 103 euro.
Llogari bankare 787 171 lekë.
Pagesë si rrjedhojë e kontratës..., likuidim kësti i dytë, 145 mijë euro.
Llogari bankare e shtuar në euro, 57 665 euro.
Të ardhura si deputete, 2 238 923 lekë.
Overdraft 761 lekë.
Overdraft 2 243 127 lekë.
Vajza Bora, llogari dyemërore, 11 940 GBP
Debi në kartën visa, 158 357 lekë.
Llogari dyemërore, 11 940 GBP 8 056 lekë.
Shlyerje overdraft, 210 208 lekë.
Djali Besari, pakësuar llogaria 28 409 lekë.
Overdraft, 306 001 lekë.




Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Meta letër KLGJ: Keni tejkaluar afatet për Gjykatën e Lartë

Presidenti i Republikës Ilir Meta i ka dërguar një letër Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi veprimtarinë e deritanishme të KLGJ-së për plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë dhe rekomandimet e misionit të ekspertizës së BE-së “Euralius V”, mbi këtë çështje. Kreu i shtetit akuzon KLGJ-në se ka tejkaluar afatin për miratimin e aktet e nevojshme nënligjore për të nisur procedurat e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Lartë sipas kushtetutës dhe ligjit. “Rezultoni se KLGJ-ja ka tejkaluar afatin fillestar 3-mujor të përcaktuar

nga neni 174/1, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016, edhe me më shumë se 3-mujor të tjerë, periudhë brenda të cilës këshilli duhet të kishte miratuar të gjitha aktet e nevojshme nënligjore për të nisur procedurat e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Lartë sipas kushtetutës dhe ligjit. Ky afat 3-mujor i përcaktuar nga ligji ka përfunduar në datën 12 mars 2019, ndërkohë që, nga ky moment kanë kaluar edhe 3 muaj e 20 ditë të tjera dhe ende Këshilli i Lartë Gjyqësor rezultoi që se nuk ka përmbyshur detyrimet e tij ligjore”, shkruan ai.



Rama mbledh Kryesinë e PS: Analizë dhe asamble brenda korrikut

Tre ditë pas zgjedhjeve lokale të 30 qershorit ku Partia Socialiste e Shqipërisë fito 60 bashki, kryeministri Rama mbledhi në seli kryesinë e kësaj partie. “Do të kemi mbledhje dhe analiza me asambletë e PS-së në çdo bashki. Diskutim për rezultatet zgjedhore dhe ecurinë e procesit të konstituimit të këshillave bashkiakë dhe kryetarëve të rinj. Pas këtij procesi do të ketë mbledhje asambleje brenda Korrikut”, mësohet se ka thënë ai.

Ndërkohë në mbledhjen e Kryesisë së PS është diskutuar edhe për hapat që do të ndërmerren për shkarkimin e Presidentit. Të hënën pritet të ngrihet edhe komisioni hetimor që do të përcaktojë nëse Presidenti Meta ka kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës me dekretin e nxjerrë për të anuluar zgjedhjet e 30 qershorit që në fakt u kryen pa incidente. Nëse Meta rezultoi “fajtor” atëherë do të vijohet me procedurat e mëtejshme për shkarkimin e tij.



Luigi Soreca: Kushtetuesja dhe SPAK-u duhet të fillojnë punën

Ambasadori i BE i përgjigjet Ilir Metës: Zbatimi i reformës në drejtësi është i pakthyeshëm

Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri Luigi Soreca, me anë të një reagimi të gjatë, është shprehur se fokusi i Shqipërisë duhet të jetë në krijimin e SPAK si dhe tek lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Deklarata e Sorecës vjen një ditë pasi presidenti Ilir Meta dha një opsion zgjidhje sipas tij, ku më 13 tetor të kryhen zgjedhje të trefishta, ato të përgjithshmet, zgjedhjet lokale si dhe zgjedhjet për President. Kujtojmë se Presidenti Meta ditën e martë pati edhe një reagim të ashpër kundër ndërkombëtarëve. Ai sulmoi edhe SHBA duke thënë se janë Qesharakë, ngatërrestar, intrigantë dhe që bëjnë lojë ambasdash. Si një përgjigje për Metën, ambasadori, Soreca ka thënë se BE do të vazhdojë të mbështesë plotësisht Shqipërinë dhe qytetarët e saj, të cilët besojnë fuqishëm në të ardhmen evropiane, ndërsa shton se Gjykata Kushtetuese pas krijimit do të jetë në gjendje të qartësojë situatën madje edhe çështjen e zgjedhjeve. Ndër të tjera Soreca ka dhënë edhe një mesazh për politikën në vend duke thënë se duhet të angazhohen për t'u ulur në dialog në mënyrë që të kapërcehet situata aktuale. “Është koha që qeveria shqiptare, opozita dhe institucionet të tregojnë pjekuri dhe të angazhohen urgjentisht në dialog për të kapërcyer situatën politike aktuale. Është gjithashtu koha të ecet përpara me reformat e sundimit të ligjit. Zbatimi i reformës në drejtësi vazhdon dhe është i pakthyeshëm. Fokusi tani është krijimi i SPAK dhe rikthimi i funksionalitetit të Gjykatës Kushtetuese. Sapo të përfundojë procesi rigoroz i rivlerësimit të kandidatëve, SPAK do bëjë të mundur që Shqipëria të rrisë më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndërsa Gjykata do të qartësojë



Soreca
“Zbatimi i reformës në drejtësi vazhdon dhe është i pakthyeshëm. Fokusi tani është krijimi i SPAK dhe rikthimi i funksionalitetit të Gjykatës Kushtetuese. Lufta kundër korrupsionit duhet të vazhdojë në mënyrë të përditshme”.

të gjitha çështjet e pazgjidhura në lidhje me të drejtat kushtetuese, përfshi çështjet zgjedhore. Lufta kundër kor-

rupcionit duhet të vazhdojë në mënyrë të përditshme. Prokuroria duhet të hetojë çdo formë të dyshuar të korrupsionit, përfshi shkeljet zgjedhore dhe blerjen e votave, në zbatim të ligjeve ekzistues. Për të konfirmuar që cikli i drejtësisë penale funksionin efektivisht është gjithashtu

e rëndësishme që gjykatat të japin dënime përfundimtare mbi akuzat të pazgjidhura për çështje serioze të krimit të organizuar. Gjithashtu, duhet të rinisë me shpejtësi puna ndërpartiake për reformën zgjedhore”, tha Soreca. Më pas ambasadori, Soreca thekson se të gjitha institucionet dhe

udhëheqësit politikë duhet të përqendrojnë përpjekjet e tyre në këto objektiva në pikëpamje të vendimit, vendimtar të KE në tetor. “Të gjitha institucionet shqiptare dhe liderët politikë duhet të përqendrojnë përpjekjet e tyre në këto objektiva, në kuadër të vendimit të rëndësishëm

të Këshillit Evropian në tetor. Bashkimi Evropian do të vazhdojë të mbështesë plotësisht Shqipërinë dhe qytetarët e saj, të cilët besojnë fuqimisht në të ardhmen evropiane të vendit të tyre”, shkruan Soreca.

**YLLI MANJANI
SULMON SORECËN**

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani ka komentuar deklaratën e Ambasadorit të BE, Luigi Soreca ku ky i fundit kërkonte që palët politike të ulen në dialog dhe jo të hyjnë në tre palë zgjedhje siç kërkoi presidenti Meta. Manjani shkruan se “që ta mbledhë mendjen Soreca e të tjerët, Shqipëria ka nevojë për rivendosi të autoritetit Kushtetues”. Sipas Manjanit zgjedhjet Parlamentare janë fillimi i zgjidhjes së çdo gjëje tjetër. “Kjo Shqipëri nuk është gati t'i bashkëngjitet Evropës, me gjithë dashamirësinë e Mogherinit që po na lë shëndën... Zgjedhjet parlamentare, ku populli shqiptar të ketë mundësinë të zgjidhë krizën. Populli shqiptar e meriton ta ketë këtë mundësi, njësoj si populli italian, austriak, spanjoll, danez e madje është si populli serb, maqedonas e grek. Të gjithë këto popuj vendosin për parlamentin e qeverinë që duan. Pse jo shqiptarët?! Kjo është çështja! Të tjerat janë pallavra”, shkruan Manjani.

Vendimi

Manja drejton komisionin për shkarkimin e Ilir Metës



Partia Socialiste vendosi dje që komisionin hetimor parlamentar për shkarkimin e Presidentit Ilir Meta ta drejtojë Ulsi Manja, i cili është edhe kryetar i Komisionit të Ligjeve. Komisioni do të ketë nëntë anëtarë, 5 nga mazhoranca dhe 4 nga opozita. Komisioni do të shkojë për votim në Kuvend në datë 8 Korrik në orën 18:00, pra ditën e hënë, të javës që vjen. Dje u zhvillua mbledhja e Konferencës së Kryetarëve ku surprizë ishte qëndrimi i kryetares së grupit Demokrat në parlamentin e Shqipërisë, Rudina Hajdari, e cila pavarësisht kritikave të forta kundër kreut të shtetit në muajt e fundit, kërkoi shtyrjen e ngritjes së Komisionit Hetimor për shkarkimin e tij. Hajdari deklaroi në përfundim të mbledhjes se arsyet që e dërguan për një vendim të tillë janë mungesa e Gjykatës Kushtetuese, por edhe për të shmangur përshtjellimin e krizës politike, që më shumë e shikon si konflikt personal Rama-Meta. Ajo tha se komisioni mund të ngrihet në një moment tjetër kur situata politike të jetë qetësuar.



Apeli
“Të gjitha institucionet shqiptare dhe liderët politikë duhet të përqendrojnë përpjekjet e tyre në këto objektiva, në kuadër të vendimit të rëndësishëm të Këshillit Evropian në tetor”.



Meta 10 pyetje ambasadorit të BE-së: Pse nuk më mbështetët për dialogun?

Presidenti Meta sulme dhe ironi Ramës dhe ambasadorit të BE-së: Timonieri ynë s'ka frena



Meta

"Kreu i shtetit shprehet se një nga shqetësimet dhe vërejtjet e tij për delegacionin e BE gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë se nuk ka bërë përpjekjet më të mira për të nxitur një dialog real midis palëve".



A të që bëri pardje për 60 minuta në konferencën për shtyp, Presidenti Ilir Meta e vijoi sërish dje, por këtë herë nga faqja zyrtare në Facebook duke vijuar luftën institucionale me qeverinë edhe ndërkombëtarët. Meta nuk ka kursyer dje në deklaratat e tij që ka nisur në Facebook as ambasadorin e BE-së në Shqipëri, Luigi Soreca, i cili po dje bëri një tjetër thirrje që qeveria dhe opozita të angazhohen në dialog. Meta i drejton 10 pyetje publike ambasadorit të BE-së, ku mes të tjerave e pyet se përse nuk e mbështeti Presidentin në iniciativën për dialog mes palëve. Kreu i shtetit shprehet se një nga shqetësimet dhe vërejtjet e tij për delegacionin e BE gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë se nuk ka bërë përpjekjet më të mira për të nxitur një dialog real midis palëve. Në një reagim të mëparshëm, Meta ngre pyetjen nëse është 'Reforma apo Ramaforma'? Më pas Meta shpjegon se çfarë është sipas tij Ramaforma, ndërsa ironizon kryeministrin Edi Rama, teksa pohon se "timonieri ynë ka timon por s'ka frena". "Mirëmëngjesi të dashur qytetarë! Reforma apo Ramaforma? Kjo është çështja. Po çfarë është Ramaforma? Përgjigje e thjeshtë: Zbatimi "krijues" i Reformës. Timonieri ynë ka timon por s'ka frena, dhe si i tillë shquhet për "krijimtari" të papërmbyqshme. Pas pak po e nisim me Kryerformën në drejtësi meqenëse pas pak ditësh nisim festimet për 3-vjetorin e miratimit të saj me 140 vota, duartrokitje dhe puthje të papërmbyqura", shkruan Meta. Po gjatë ditës së djeshme, Meta vijoi akuzat kundër kryeministrit Rama për Reformën në Drejtësi. Meta duke ironizuar kreun e qeverisë shpjegon sipas tij se ku është bazuar ajo që ai e cilëson si 'Ramaforma'. "Reforma në Drejtësi u bazua te Komisioni i Venecias. Po Ramaforma ku bazohet?! Përsëri frymëzimi buron nga Venecia, por jo nga Komisioni, por nga Bialja e Venecias. Pse? Sepse timonieri ynë është vetëm artist", shkruan ai. Por Meta nuk e mbyll me kaq, teksa shkruan se do të vijojë me një cikël të gjatë, shpjegues dhe çtensionues duke premtuar të tjera statute në faqen e tij në Facebook.

REAGIMI I PLOTË I METËS PËR SORECËN

"Presidenti i Republikës përshëndet nxehtësisht thirrjet e singerta të ambasadorit Soreca për "pjekuri politike dhe për angazhimin urgjentisht në një dialog politik për të kapërcyer situatën aktuale". Me këtë rast Presidenti ka disa pyetje publike:

-A ishit ju realisht për nxitjen e dialogut mes palëve më parë z. ambasador?

-A morët ju ndonjë nismë konkrete për vendosjen e këtij dialogu mes palëve?

-A i kërkuat ju mbështetjen Presidentit për dialog, me qëllim që t'ja kursenim shfaqjen e shëmtuar të 30 qershorit Shqipërisë dhe së ardhmes së saj evropiane?

-A e dini ju që Presidenti mori një nismë për anulimin e zgjedhjeve me qëllim vendosjen e dialogut mes palëve?

Përse nuk e mbështetët ju Presidentin në këtë iniciativë publikisht?

-A e dini ju që në 24 maj 2019 përfaqësuesit zyrtarë të grupit kryesor në Bundestag, deputetët Wadehul dhe Schmidt, përmes një qëndrimi zyrtar kërkuar vendosjen urgjent të dialogut për zgjidhjen e krizës, madje u ofruan për moderimin e këtij dialogu me qëllimin e mirë për të ndihmuar në çeljen e negociatave të anëtarësimit me BE-në dhe theksuan edhe rëndësinë e një date të re për zgjedhjet vendore, që të ishin demokratike dhe gjithëpërfshirëse, si domosdoshmëri për të ndihmuar çeljen e negociatave?

-A e dini ju që Presidenti menjëherë reagoi duke mbështetur këtë nismë dhe tregoi vullnetin e tij për të dekretuar një datë të re të zgjedhjeve, pas dakordësimit të palëve?

-A e dini ju që Presidenti i Republikës ka dekretuar datën 13 tetor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve lokale gjithëpërfshirëse? Çfarë qëndrimi keni ju?

-A e keni sqaruar z. Rama se zgjedhjet pa opozitën nuk plotësojnë kriteret e Kopenhagës, shkelin parimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe pamundësojnë çeljen e negociatave të anëtarësimit në tetor 2019?

-A e dini ju që po dje Presidenti ka theksuar, duke patur parasysh rëndimin e krizës politike në vend, që 13 tetori 2019 të jetë jo vetëm data e zgjedhjeve lokale, por edhe e atyre parlamentare dhe presidenciale, për t'i dhënë fund njëherë e mirë kësaj krize të thellë dhe të gjithanshme të përfaqësimit në vend?

Ju e dini shumë mirë, që ditën e parë që keni mbërritur këtu, se një nga shqetësimet dhe vërejtjet e mia për Delegacionin e BE gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë se nuk ka bërë përpjekjet më të mira për të nxitur një dialog real midis palëve.

Për pyetjet e tjera për Reformën në Drejtësi dhe Gjykatën Kushtetuese do vijoj më vonë, por dialogu, temat, mënyrat dhe objektivat e tij të përcaktuara qartë janë prioriteti numër një për momentin, sipas mendimit tim. Përshëndetjet më të përzemërta dhe bashkëgjyritur po ju kujtoj publikisht dhe qëndrimin zyrtar të Zv/kryetarit të Grupit parlamentar të CDU/CSU në Bundestagun gjerman, z. Johann Wadehul".

Rama-Metës: Kollaj të inatosesh, por zgjidh njeriun dhe kohën e duhur

Kryeministri Edi Rama iu është përgjigjur akuzave të drejtpërdrejta të Presidentit Meta, me një shprehje të Aristotelit. "Çdokush mund të inatoset - kjo është kollaj, por të inatosesh edhe me njeriun e duhur, edhe në masën e duhur, edhe në kohën e duhur, edhe në mënyrën e duhur, kjo jo, kjo nuk është e lehtë dhe jo çdokush e ka këtë fuqi", shkruan Rama. Edhe ministrja e Shtetit Për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali ka reaguar në pas sulmeve të Metës ndaj ndërkombëtarëve. "Poshtë Soreca, Borchardt, Palmer, Juncker, Glover, Mogherini, Lajçak,

Hahn, Moavero e kush të jetë me ta, mbi ta, pas tyre me gjithë Soros e sorrollop, i tërë soji i armiqve të shqiptarit Baba Xhike, me dy krena e me qafore, që hedh bomba mbi çdo llaxore dhe mahnit çdo fallxhore". Më herët ministrja Elisa Spiropali ka pohuar se "Baba Xhikja na la po Reformën në Drejtësi meazallah se e lëshon në rrokullimën e tij të zhurmshme! Ajo i del në gjumë, në ujë, në bukë, madje edhe në rrugë. Të shkretit Baba Xhike nuk i iket pa e vrrarë atë drejt reforme, që e shih si top, tank, kundërshtar, agresor ndërkombëtar".

Meta: Timonieri zgjodhi kryeprokuroren me 69 vota

Presidenti Ilir Meta ka bërë një tjetër reagim publik mbrëmë ku thotë se pasi Edi Rama erdhi në pushtet në shtator të 2017 nisi tjetërsimin e Reformës në Drejtësi duke e kthyer në Ramaformë. Meta tha se Rama zgjodhi kryeprokuroren me 69 vota. "Komisioni Venecias rekomandonte se emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm është i rëndësishëm dhe duhet të tërheqë një shkallë të lartë konsensusi pa kompromentuar cilësitë e një kandidati të suksesshëm. Zgjedhja e njëanshme e këtij institucioni (PP) nga mazhoranca do të shkaktonte mungesë besimi nga opozita tek standardet e reformës dhe do

të krijonte bindjen se mazhoranca e kohës po kapte sistemin e ndjekjes penale. Por si mund të rrinte sistemi i drejtësisë pa patur një PPP (Prokuror të Përgjithshëm të Përkohshëm)?! Për këtë, Timonieri, në mënyrë shumë krijuese, nëpërmjet një ligji shpiku një "PPP", institucion ky që nuk ekziston asgjëkund në Kushtetutën e Shqipërisë, të miratuar me 140 vota në 21-22 korrik 2016. Falë vizionit të Ulsiut dhe certifikatës së ekspertëve të EURALIUS e jo vetëm, nëpërmjet një interpretimi artistik, Timonieri ia doli që në dhjetor 2017 të zgjidhte Prokurorin e Përgjithshëm të Përkohshëm (PPP) vetëm me 69 vota".



Kryebashkiakët e PD kundër Bashës: Gati për zgjedhje më 13 tetor

Vendimi, më 8 korrik opozita në protestë. Kryebashkiakët kundërshtojnë linjën e kreut duke paralajmëruar se po përgatiten për zgjedhje të reja

Demokratët rinisin protestat. Kreu i PD-së Lulzim Basha ka caktuar 8 korrikun, ora 20:00 për mbajtjen e protestës së radhës, e dhjeta kombëtare kundër qeverisë. Vendimi u mor dje në një mbledhje që Basha pati me kryetarët e degëve të PD-së në rrethe. Por ndërkohë, po dje, një mbledhje e mbajtur më parë, në orën 16:00 ka pasur përplasje qëndrimesh mes kryedemokratit dhe kryetarëve të bashkive zgjedhur nga PD, të cilët janë shprehur hapur kundër Bashës, ku kanë shprehur hapur qëndrimin e tyre se duan të garojnë sërish në zgjedhjet e dekretuara më 13 tetor për pushtetin vendor.

13 tetori është data e re që presidenti Ilir Meta ka dekretuar për zgjedhjet vendore të 2019-ës, një dekret i konsideruar nul nga mazhoranca që e çoi vendin në garë elektorale për kryebashkiakët më 30 qershor, pa pjesëmarrjen e PD-LSI dhe aleatëve të tyre. Por edhe pse lideri demokrat Lulzim Basha e konsideroi nul 30 qershorin, ai refuzoi dekretin e Metës për 13 tetorin, duke thënë se problemi nuk është data, por fakti që zgjedhjet nuk duhet të mbahen me Ramën kryeministër dhe pa u vënë para drejtësisë personat e përfshirë në shit-blerje votash.

Në fakt, kundër këtij vendimi të Bashës, kanë dalë vetë kryebashkiakët e zgjedhur të PD-së të cilët thanë se nuk do t'i lirojnë zyrat të zgjedhurve të

rinj socialistë nga 30 qershori dhe se duan të bëhen zgjedhje më 13 tetor.

MZIU: NUK KA LIDHJE BASHA, POR LIGJI E VOTA POPULLORE

Që kryebashkiakët e djathtë janë kundër Lulzim Bashës e la të kuptojë Xhelal Mziu pasi doli nga një takim i kryedemokratit me kryetarët e bashkive në selinë blu. Mziu, kryebashkiak i Kamzës, u shpreh i vendosur se nuk do t'i lirojë zyrën Rakip Sulit, kryebashkiakut të zgjedhur më 30 qershor nën siglën e PS-së. Tha qartë se në këtë vendim nuk ka lidhje Lulzim Basha. Ai është shprehur se nuk do ta lë zyrën

Kundërshtimi
Kryebashkiakët kundërshtojnë linjën e kreut duke paralajmëruar se po përgatiten për zgjedhje të reja vendore më 13 tetor, në zbatim të dekretit të Presidentit Ilir Meta, të cilin Lulzim Basha nuk e ka pranuar.

para zgjedhjeve të 13 tetorit. “Vendimi për këtë është marrë në datën 30 që ishin zgjedhje të paligjshme, e tregoi edhe pjesëmarrja e popullit - tha fillimisht Mziu, i cili më pas kur u pyet nga gazetarët se edhe nëse jua kërkon Lulzim Basha nuk do të dilte nga zyra u përgjigj:

Nuk ka lidhje Lulzim Basha. Ne interpretojmë ligjin dhe kemi lexuar votat popullore. Ky është mendimi i shumicës së shqiptarëve, 87%.”

KAPLLANAJ: GATI PËR ZGJEDHJE MË 13 TETOR

Kryetari demokrat në ikje

Kreu i PD

Basha fsheh përplasjet me kryebashkiakët e PD: Më 8 korrik çmontojmë diktaturën

Lideri demokrat Lulzim Basha e lshmangu përgjigjen nëse u ka kërkuar kryebashkiakëve të PD-së të lirojnë ose jo zyrat për pasardhësit socialistë të zgjedhur nga 30 qershori. Në një prononcim për gazetarët pas mbledhjes të Kolegjit të Kryetarëve, kryedemokrati Lulzim Basha nuk dha përgjigje për këtë fakt, dhe u ndal vetëm në bërjen publike të datës 8 korrik për protestën e radhës kombëtare të PD-së kundër qeverisë. “Dua të falënderoj nga zemra edhe njëherë mbi 85 përqind të

shqiptarëve që refuzuan diktaturën, farsën e Edi Ramës me 30 qershor. Dua ti ftoj të gjithë këta qytetarë dinjitozë të Shqipërisë europiane, nëna e baballarë, të rinj e të reja, prindër e bijë nënash shqiptarë, të na bashkohen ditën e hënë në orën 20.00 në një protestë të madhe kombëtare për të qëndruar të bashkuar me mirënjohje të thellë, me besim tek vetvetja dhe tek njëri-tjetri dhe për të vazhduar të vendosur, pa asnjë hap pas betejës tonë për çmontimin e diktaturës, për demokracinë, për Kushtetutën,

për lirinë, fëmijët, familjet tuaja dhe të ardhmen e Shqipërisë Europiane. Të gjithë bashkë ditën e hënë në orën 20.00 në Tiranë. Faleminderit!” tha Basha. Kujtojmë se para kryetarëve të PD-së në rrethe, Basha takoi në selinë blu kryetarët e bashkive. Disa prej tyre folën për mediat duke thënë se nuk kanë ndërmend të lirojnë zyrat për të zgjedhurit e rinj nga 30 qershori, dhe se ata nga ana e tyre janë gati të shkojnë në zgjedhje më 13 tetor, një datë kjo e dalë nga dekreti i dytë i Metës që nuk është pranuar nga Basha.



i Bashkisë së Mallakastrës, Agron Kapllanaj, thotë se zgjedhjet e 30 qershorit nuk do të njihen nga demokratët. Ato janë nul - tha ai pas njëmbledhje që kryebashkiakët e djathtë patën në selinë blu me kryetarin Lulzim Basha, duke paralajmëruar se do të qëndrojnë në detyrë dhe nuk do t'i lëshojnë postin kryebashkiakëve të rinj të Partisë Socialiste të zgjedhur më 30 qershor. “Do ta lirojmë zyrën kur të vijë pasardhësi jonë i zgjedhur sipas ligjit. Kur të

ketë zgjedhje jo votime, këto votime nuk i njohim. Ky është vendim i marrë, i bërë i ditur edhe nga opozita nga kryetari, ky është një vendim që e kemi shprehur disa herë këto janë zgjedhje farsë, nul nuk do të njihen. Do vazhdojmë të qëndrojmë në detyrën tonë. Nëse do të vijë të fitojë në zgjedhjet e tjera, ne do ta mirëpresim do t'i dorëzojmë shiritin sipas rregullave. Nuk mbaj me dhunë asnjë zyrë, por do t'i shërbejmë qytetarëve. Nuk është problemi nëse e kërkon Basha apo dikush tjetër, zgjedhjet janë nul, janë votime për partinë socialiste”, u shpreh Kapllanaj. Në zgjedhjet e 30 qershorit, Qerim Ismailaj, kandidat nga Partia Socialiste fitoi me 5692 vota përballë kandidatit nga Bindja Demokratike Rober Brahaj, i cili mori 471 vota.

Sipas Kapllanajt, nuk mundet që Mallakastrën ta drejtojë një kryebashkiak që ka marrë vetëm votat e militantëve të PS-së siç ai u shpreh. “Kandidati ka marrë 13 % të votave, aq janë vetë anëtarë të PS-së. ai është kryetari i militantëve të PS-së në atë zonë, nuk është i qytetarëve”, tha Kapllanaj, duke sjellë në vëmendjen se në 2015-ën ai ka fituar garën përballë kandidatit socialist që kishte 2080 vota më shumë sesa ka marrë më 30 qershor Qerim Ismailaj.

DEBATI / EDHE BASHA SI META KUNDËR NDËRKOMBËTARËVE

Kreu i PD: Kush njih 30 qershorin është kundër demokracisë

Pasi presidenti Ilir Meta sulmoi ndërkombëtarët duke thënë se nuk kanë bërë përpjekje reale për dialog politik për zgjidhjen e krizës në Shqipëri, në të njëjtën linjë, edhe kryedemokrati Lulzim Basha radhitet kundër ndërkombëtarëve. Në një reagim për procesin zgjedhor të 30 qershorit, të cilin ai e quan nul, duke “shigjetuar” ndërkombëtarët Basha tha se çdokush që njih zgjedhjet

e 30 qershorit nuk i shërben demokracisë dhe interesit të shqiptarëve. “30 qershori ishte jo vetëm veprim antik-ushitetues dhe antidemokratik, por edhe një veprim me kosto politike e shoqërore që dëmton direkt interesat e qytetarëve. Votimet e 30 qershorit, përtej një farse antiligjore, u manipuluan me cdo mjet dhe mënyrë, që nga manipulimet ligjore dhe kërcënimet e votuesve tek manipulimi i

votimit dhe numërimit. Çdokush që pranon në heshtje apo pajtohet me vetëdije me këtë shkatërrim të Kushtetutës dhe të institucionit themelor të demokracisë, zgjedhjeve të lira, nuk i shërben as demokracisë dhe as interesit të shqiptarëve”, theksoi Basha. NPor duket se lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka një qëndrim krejt tjetër nga presidenti Ilir Meta për zgjidhjen e krizës politike në

Shqipëri. Teksa kreu i shtetit dha propozimin e tij për ta kthyer 13 tetorin në datë për tre zgjedhje, vendore, parlamentare dhe presidenciale, kreu demokrat zgjidhjen politike e sheh tek ndëshkimi i fenomenit të shit-blerjes së votave. “Kriza politike në Shqipëri nuk mund të zgjidhet me pandëshkueshmëri, duke i bërë lëshime apo duke falur krimet, vjedhjet dhe shkeljet e ligjit. E vetmja rrugë drejt politikës



normale dhe demokratike është ajo e sundimit të ligjit, që do të thotë, mbi të gjitha, një gjë: ndëshkim të politikanëve që kanë vjedhur zgjedhjet dhe kanë bashkëpunuar me krim-

in. Ndëshkimi i politikanëve që kanë vjedhur zgjedhjet në bashkëpunim me krimin dhe sundimi i ligjit nuk mund të diskutohen apo negociohen në tavolina politike”, tha Basha.

KQZ: Në 30 Qershor votuan 22.97% e shqiptarëve

Dalin shifrat zyrtare, 765825 vota të vlefshme, PS 727.180, Bindja Demokratike 38.646 dhe 45767 të pavlefshme

Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019, Partia Socialiste, e cila në shumicën e bashkive kishte vetëm kandidatë të saj pa kundërshtarë përballë, mori 727.180 vota, nga 765825 vota të vlefshme që shkuan për të gjithë kandidatët për kryetarë bashkie. Diferenca prej 38.646 votash ka shkuar për kandidatët e tjerë, shumica prej të cilëve të Bindjes Demokratike, dhe një pjesë e vogël të pavarur.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve doli dje në një konferencë për mediat, ku përmes zëdhënësës, Drilona Hoxhaj, dha numrin në total të shqiptarëve që shkuan në votime, 812249 ose 22.97%. Një shifër kjo që ndryshoi nga ajo që u raportua paraprakisht nga KQZ menjëherë pas procesit të votimit të 30 qershorit, që ishte 771.863 votues.

Votat që PS-ja ka marrë për kandidatët në të gjithë vendin në të 61 bashkitë janë 727.180 vota, Ndërkohë për këshillat bashkiakë në të gjithë vendin PS-ja ka marrë 563 693 vota, sipas burimeve të Report Tv. Nëse këtë shifër do ta krahasojmë me atë të zgjedhjeve lokale të 2015, ku PS-ja mori asokohe 402.000



vota, rezulton se në 30 Qershor Partia Socialiste ka marrë 161693 vota më shumë se para katër viteve. Në përfundim të deklaratës për shtyp,

zëdhënësjë e KQZ-së u tregua e kujdesshm që të theksonte se rezultatet janë paraprake. “Rezultati përfundimtar zyrtar do të shpallet vetëm pas përfundimit të afateve ankimore pranë KQZ apo Kolegjin Zgjedhor” tha Drilona Hoxhaj.

SHIFRAT E KQZ-së TË ZGJEDHJE VENDORE	
NË ZGJEDHJE MORËN PJESË 812249 SHQIPTARË OSE 22.97%	
VOTAT PËR KANDIDATËT DHE KËSHILLTARËT;	
765825	për kandidatët për kryetarë bashkie
760933	për kandidatët për këshilltarë bashkie
VOTA TË PAVLEFSHME	
45767	për kandidatët për kryetarë
49986	për kandidatët për këshilltarë
Mungojnë fletët e votimit të dëmtuara dhe ato që janë hedhur gabim.	

fundimit të afateve ankimore pranë KQZ apo Kolegjin Zgjedhor” tha Drilona Hoxhaj.

Po ashtu, për herë të parë, KQZ nxori edhe numrat për votat e pavlefshme: 45767 vota për kandidatët për kryetarë kanë dalë të pavlefshme; 49986 vota të pavlefshme për kandidatët për këshilltarë

Nëse marrim numrin total

të shqiptarëve që votuan dhe zbresim numrin e votave që kanë marrë kandidatët, diferenca del 46424. Kjo është një shifër më e madhe se votat e pavlefshme që KQZ deklaroi dje. Shqiptarja.com u interesua për këtë diferencë me 675 vota, dhe nga sa mësoi nga KQZ në votat zyrtare që janë shpallur të pavlefshme

mungojnë fletët e votimit të dëmtuara dhe ato që janë hedhur gabim. Për këto fletë do të bëhet një vlerësim nga KQZ nëse do të quhen të tilla, apo nëse do të vendoset të shpallen të vlefshme. Duhet theksuar një risi e këtyre zgjedhjeve ishte numri i madh i votave të pavlefshme. Ky numër është madje më i madh se votat që mbledhi partia Bindja Demokratike, partia e vetme e djathtë që hyri në këto zgjedhje, e themeluar nga As-trit Patozi veçse një muaj para datës së votimeve. Konkretisht 7121 vota më shumë. Bindja Demokratike mbledhi rreth 38.646 vota që janë afërsisht 4-5% e votave të përgjithshme, ndërsa 45767 vota kanë dalë të pavlefshme. Kujtojmë se nga 61 bashki, 60 prej tyre u fituan nga kandidatët e Partisë Socialiste dhe një bashki, ajo e Finiqit, nga partia MEGA, aleate e socialistëve.

NË REPOLITIX / “META HOQI DORASHKAT DHE BËRI SHUMË GAFA!”

Rudina Hajdari: Bashës i ka dalë situata jashtë kontrollit

Kryetarja e grupit parlamentar demokrat Rudina Hajdari e ftuar në emisionin Repolitix në Report Tv përballë gazetarit Denis Minga, e cilësoi të turpshme deklaratën e Presidentit Meta në të cilën sulmoi faktorin ndërkombëtar. Sipas deputetes Hajdari, Meta hoqi dorashkat dhe nuk u soll si President duke shtuar se ndërkombëtarët e huaj kanë luajtur gjithmonë një rol konstruktiv në Shqipëri. Sa i përket situatës brenda PD-së, deputetja thotë se selia blu po vuan gabimin e djegies së mandateve. Lidhur me situatën në PD pas zgjedhjeve të 30 qershorit, Hajdari mendon se Bashës i ka dalë situata jashtë kontrollit. Rudina Hajdari thotë se zgjedhjet e 30 qershorit janë fakt, ato tashmë janë bërë dhe ligjshmërinë ose jo të tyre mund ta ndërmarrë vetëm Gjykata Kushtetuese. Duke komentuar vendimin e kryebashkiakëve të PD-së për të mos liruar zyrat për të zgjedhurit e rinj socialist nga 30 qershori, kryetarja e grupit parlamentar demokrat, tha se kjo është një situatë që i ka dalë nga duart kryedemokratit Basha, ndërsa paralajmëroi se do të ketë përplasje. “Do të kemi një vendim nga Gjykata Kushtetuese, ndoshta do reflektojmë përse ndodhën këto, në një fazë post zgjedhje. Nuk e parashikoj dot nëse do të kemi zgjedhje të tjera. Fakti është që zgjedhjet ndodhën pa pasur opozitën. Një nga partitë më të mëdha të vendit nuk mori pjesë dhe kjo është për të ardhur keq. Nëse do të përsëriten këto zgjedhje do ishte një gjë për tu parë më vonë kur të



kemi një Gjykatë Kushtetuese”, tha Hajdari. Për vendimin e kryebashkiakëve të PD-së u shpreh: “Është një situatë që i ka dalë jashtë kontrollit. Kryetari i PD nuk është në gjendje të shikojë dhe të gjejë një zgjidhje për këta kryetar bashkie që refuzojnë të largohen nga zyrat e tyre. Mendoj se kjo do të sillte përplasje. E shikoj që

kjo do ndodhë, sepse shumë njerëz të thjeshtë do të humbin njerëzit e punës, dhe këtë gjë nuk mund ta ndalojë dot asnjë njeri. Zgjedhjet dolën, u certifikuan deri diku dhe do të ketë një zëvendësim të kryetarëve të bashkive, dhe detyrimisht këta që kanë qenë do zëvendësohen me të rinjtë që fituan në zgjedhjet e

30 qershorit. Unë e shikoj të pashmangshme. Është e kotë të themi që nuk i njohim këto zgjedhje. Nuk është në tagrin e këtyre kryebashkiakëve, nuk mund të bëjnë rolin e gangsterëve. Mendoj se zoti Basha ndodhet në situatë të vështirë”.

Referuar konferencës për mediat që Presidenti Ilir Meta mbajti ku

kërkoj që më 13 tetor të mbahen sërish zgjedhjet vendore, por edhe parlamentaret dhe për Presidentin, kryetarja e grupit parlamentar demokrat tha se kreu i shtetit në mënyrë të turpshme sulmoi ndërkombëtarët. “Ndoshta këto zgjedhje nuk ishin ideale. U bojkotuan nga opozita. Kjo nuk duhej të kishte ndodhur. Ne duhet të pranojmë fajet tona dhe të ecim përpara sepse jemi përpara vendimit të tetorit për hapjen e negociatave. Sa i përket presidentit dhe konferencës ishte një dalje e cila nga të gjithë u pa problematike se ai hoqi petkun e një burrë shteti dhe foli në një mënyrë që nuk i takon një presidenti të flase në emër qoftë të popullit. Pashë një president të shqetësuar, hoqi dorashkat por bëri dhe shumë gafa në atë prezantim dhe në mënyrë të turpshme atakoi ndërkombëtarët që nuk i takon presidentit t’i sulmojë në atë lloj mënyrë ndërkombëtarët që luajnë një rol konstruktiv në Shqipëri, sugjerues, dhe nuk kanë fare të bëjnë me vendimet tona. Në këtë krizë ndërkombëtarët kanë zgjedhur të zgjidhet midis nesh, dhe ne nuk arritëm dot ta zgjidhim. Ishte një situatë e vështirë për të gjithë, nuk do donim të kishim zgjedhje pa opozitën. Presidenti duhet të reflektojë. Presidenti duhej të ishte në Shqipëri kur opozita dogji mandatet, jo në Gjermani. Të mos e kishte lënë këtë hap të opozitës të bëhej sepse solli pasojat shkatërruese për vendin, prandaj kemi këtë situatë që mazhoranca ka uzurpuar institucionet. Edhe opozita ka përgjegjësinë e saj në situatën që jemi sot”, tha Hajdari.

REAGIMI / RAMA SHQIPËRIA S'KA SHKELUR ASNJË KRITER

Rama: Ja dhe vizat s'u rikthyen, e vërteta doli fiks siç e thamë

Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas vendimit të Komisionit Europian për të rrëzuar kërkesën e Holandës për rikthimin e vizave për shqiptarët. Kreu i qeverisë thotë se e vërteta doli fiks sikur e kishte thënë. “Ja dhe vizat s'u rikthyen siç predikuan e trumbetuan lajmësit e gametit që s'ndodhi! Komisioni Europian e refuzoi kërkesën e qeverisë holandeze dhe e vërteta doli fiks siç ishte kur e thamë e shumëkush s'e besoi: Vizat nuk rikthehen sepse Shqipëria s'ka shkëlur

asnjë kriter”, tha Rama. Ndërkaq, në një lidhje telefonike në studion e lajmeve të Report Tv, zv/ministri i Jashtëm, Sokol Dedja ka komentuar refuzimin e kërkesës së Holandës nga Komisioni Europian për rikthimin e vizave me Shqipërinë. Dedja ka përsëritur këtë vendim duke thënë se një veprim i tillë ishte i pritshëm pasi Shqipëria është përmirësuar shumë që nga heqja e vizave. Dedja ka deklaruar se kërkesa e Holandës ka qenë më shumë politike se sa një problem real. Më pas

ka shtuar se Shqipëria do të punojë për krijimin e lidhjeve të mëtejshme të vendeve të ulëta si Holanda, Belgjika apo Brukseli. “Rritje e konsiderueshme e kërkesave për azil, rritja e kërcënimit për sigurinë, mungesë bashkëpunimi për riatdhesimin.. këto faktorë kanë ndikuar negativisht. Por në të gjitha këto fusha Shqipëria tregon përmirësim. Edhe azili dhe shifrat e emigracionit të paligjshëm janë në ulje. Nuk gjykoj vendime politike. Por nuk ekzistonte

baza për pezullimin e përkohshëm për viza nga Holanda. Është synimi jonë që të bashkëpunojmë më vendete e ulët që të luftojmë krimin e organizuar dhe probleme të lartpërmendura. Edhe KE e konfirmon, emigracioni kërkesat për azil... nuk ka rritje për të pezulluar vizat përkundrazi ka përmirësim për këtë. Ka vend për përmirësim sigurisht... për të punuar më tej dhe për të bashkëpunuar me holandezët”, ka thënë ndër të tjera Dedja.



Brukseli rrëzon kërkesën e Holandës për kthimin e vizave për Shqipërinë

Brukseli rrëzon Holandën. Komisioni Europian nuk pranon kërkesën e Holandës për rikthimin e vizave për Shqipërinë. Lajmi u konfirmua për Shqiptarja.com dhe Report Tv nga zëdhënësi i zyrës së BE-së në Tiranë. Komisioni Europian mësohet se është shprehur se pas vlerësimit të situatës aktuale, Shqipëria nuk plotësohen mekanizmat për pezullimin e vizave. “Pas një vlerësimi të kujdesshëm të përmbajtjes së njoftimit të marrë nga Holanda dhe bazuar në informacionin në dispozicion dhe të dhënat përkatëse, Komisioni vlerëson se në situatën e tanishme nuk janë rrethanat për të aktivizuar mekanizmin e pezullimit të vizave”, thuhet ndër të tjera në përgjigjen e KE-së për kërkesën e Holandës. Në datë 16 Prill Holanda miratoi në parlament një rezolutë, të cilën ia dërgoi KE-së duke i kërkuar që të pezullojë lëvizjen e lirë për shqiptarët për dy arsye, e para nivelin e kriminalitetit dhe e dyta fluksin e emigrantëve të paligjshëm, të cilët kërkojnë edhe azil. Por shifrat që publikonte si justifikim Holanda nuk ishin bindëse, pasi në vitin 2015 numri i azilkërkuësve ka qenë 1005 dhe në 2016 ka shkuar në 1665, në vitin 2017 ka rënë në 365 dhe në vitin 2018 ka pasur 550 shqiptarë që kanë kërkuar azil, por ashtu edhe niveli i kriminalitetit është shumë i vogël. Pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni Europian e hodhi poshtë.

DORËZOHET HOLANDA PËR VIZAT

Pas refuzimit nga Komisioni Europian të kërkesës për rikthimin e vizave për shqiptarët ka reaguar qeveria holandeze, e cila qëndrimin e ka përcjellë përmes ambasadores në Tiranë. Qeveria holandeze thekson se do të vijojë që të punojë me qeverinë shqiptare për të adresuar zgjedhjen e problemeve të

Holanda dorëzohet për vizat pas refuzimit nga Brukseli: Do punojmë me Shqipërinë për zgjidhjen e dy problemeve

azilit dhe krimit të organizuar. “Në datën 1 korrik, Ministri i Punëve të Jashtme të Holandës ka marrë një përgjigje nga Komisioni Europian në lidhje me letër-kërkesën e

dërguar në datën 31 Maj 2019. Në këtë letër, Komisioni ka dalë në përfundimin se kushtet teknike për të aktivizuar mekanizmin e pezullimit të vizave nuk plotësohen. Por

gjithsesi, në letër theksohet se Komisioni beson se Shqipëria duhet të vazhdojë dhe të intensifikojë përpjekjet e saj për të adresuar çështjen e aplikimeve të pabazuara për azil dhe për të

parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar. Sinjali që vjen nga letër-kërkesa vijon të jetë i rëndësishëm. Holanda do të punojë me Shqipërinë për të parë se si shqetësimet tona në

lidhje me krimin e organizuar, aplikimet e pabazuara për azil dhe klandestinët që përpiqen të kalojnë në Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet porteve të Holandës mund të adresohen në mënyrë më efektive. Ne e vlerësojmë bashkëpunimin tonë të mirë me palën Shqiptare dhe e shohim si thelbësore adresimin e këtyre çështjeve”, thuhet në reagim.

SORECA: KOHA TË ECIM PËRPARA

Menjëherë pasi u dha lajmi se Komisioni Evropian ka refuzuar kërkesën e Holandës për rikthimin e vizave me Shqipërinë, ka reaguar edhe Ambasadori i BE në vendin tonë, Luigi Soreca. Ai përveçse ka konfirmuar lajmin ka dhënë edhe disa këshill për Shqipërinë. Soreca me anë të një reagimi në Twitter ka shkruar se Shqipëria nuk ndodhet në rrethanat kur mund të vihet në lëvizje mekanizmi për pezullimin e vizave. Sipas ambasadorit, pas këtij konfirmimi është koha që Shqipëria të çojë më tej arritjet e saj të rëndësishme të vitin 2010 dhe për të ecur përpara me energji të përtërra, duke pasur parasysh vendimin e rëndësishëm të Këshillit të BE-së në tetor. “Pas një vlerësimi të kujdesshëm të përmbajtjes së kërkesës së Holandës dhe bazuar në të dhënat përkatëse të informacionit në dispozicion, Komisioni i BE-së ka vendosur që në situatën aktuale nuk janë plotësuar rrethanat për të vënë në lëvizje mekanizmin e pezullimit të vizave. Komisioni sigurisht do të vazhdojë të monitorojë nga afër përmbushjen e standardeve për liberalizimin e vizave për Shqipërinë, si dhe për vendet e tjera që përfitojnë nga udhëtimi pa viza. Tani është koha që, pas këtij konfirmimi, Shqipëria të çojë më tej arritjet e saj të rëndësishme të vitin 2010 dhe për të ecur përpara me energji të përtërra, duke pasur parasysh vendimin e rëndësishëm të Këshillit të BE-së në tetor. BE për Shqipërinë”.



Komisioni Evropian

“Pas një vlerësimi të kujdesshëm të përmbajtjes së njoftimit të marrë nga Holanda dhe bazuar në informacionin në dispozicion dhe të dhënat përkatëse, Komisioni vlerëson se në situatën e tanishme nuk janë rrethanat për të aktivizuar mekanizmin e pezullimit të vizave”.

Komisioni Europian nxjerr bluf Metën për vizat

Vendimi i Komisionit Evropian për të rrëzuar kërkesën e Holandës për rikthimin e vizave për Shqipërinë, ka nxjerrë bluf Presidentin Ilir Meta, i cili paralajmëroi ditën e hënë se nëse thellohej kriza do të

riktheheshin vizat për Shqipërinë. “Kjo krizë politike nuk e ndihmon Shqipërinë. Do bëj çdo gjë për të ruajtur atë që kemi fituar në 30 vjet. Është mirë të mos e provojë askush kokëfortësinë time për mbrojtjen

e interesave të Shqipërisë...është mirë. Nuk jam vetëm. Janë shumë shqiptarë. Rrugë për në Korenë e Veriut Shqipëria nuk ka për të bërë. Po u thellua kriza, do rivendosen edhe vizat”, tha Meta.

Shoqëria Përmbartimore “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme:

Arë + Truall me Nr. Pasurie 74/304 Volum 2, Faqe 178, Zonë kadastrale 2131 me sipërfaqe 600 m², me vendodhje Përmet, Këlcyrë

Çmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 280,000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.

Pasuria është në pronësi të Naim Avdul Allamani dtl. 02.07.1962, Ilir Avdul Allamani dtl. 08.08.1970 dhe Floreshe Avdul Musollari dtl. 07.10.19630,

• Mbi pasurinë është vënë hipotekë në favor të “Agrokredit” Sh.a, për Shumën prej 500,000 (pesëqind mijë) Lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e shoqërisë “REAL BAILIFF SERVICE” sh.p.k, në datë 29.07.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. “Pjeter Bogdani”, Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.



Shoqëria Përmbartimore “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme:

Arë, Nr. Pasurie 213, Vol.1, Faqe 85, ZVRPP Diber, ZK Nr.3454, sipërfaqe 2,625 m², me adresë: Sinë e Poshteme, Arras, Diber në pronësi të Izmir Shaban Tafa dtl.20.12.1987, Shaban Imer Tafa dtl.13.06.1940 dhe Bardhe Ali Tafa dtl.17.05.1949,

Çmimi me të cilin fillon ankandi i tretë është 194,400 (njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind) Lekë.

• Mbi pasurinë e mësipërme është vënë hipotekë për shumën 150,000 (një qind e pesëdhjetë mijë).

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e shoqërisë “REAL BAILIFF SERVICE” sh.p.k, në datë 30.07.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. “Pjeter Bogdani”, Pall. 8/1, Kati I, Tiranë Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.



Boshti franko-gjerman emëron drejtuesit e rinj të BE

Nuk 'votohet "miku" i Lulzim Bashës, Komisioni drejtohet nga krahu i djathtë i kancelares Angela Merkel

Pas orësh dhe ditësh të tëra negociatash, Bashkimi Evropian ka gjetur gjuhën e përbashkët për emërimet e drejtuesve të rinj të Unionit. Duket qartë në to fitorja e boshtit franko-gjerman, që ka vënë vulën, duke forcuar edhe më tej pozitën drejtuese në BE.

PRESIDENTJA E KE

Shtetet e BE kanë nominuar ministren gjermane të Mbrojtjes Ursula von der Ley-



e kancelares, Angela Merkel, e cila deri tani ka shprehur mbështetjen e saj të hapur për kryeministrin Edi Rama.

Propozimi për presidenten e re të KE ka pasur mbështetjen e Francës dhe Spanjës. Edhe katër vende të Europës Lindore, Hungaria, Polonia, Çekia dhe Sllovakia e kanë mbështetur propozimin, siç bëri të ditur në një mesazh lëshuar në Twitter zëdhënësi i qeverisë hungareze.

Kancelarja gjermane Angela Merkel abstenoj gjatë nominimit të Von der Leyen, sepse koalicioni i madh në Berlin nuk arriti në marrëveshje. Kryesia e socialdemokratëve nuk e pranon nominimin e saj.

SHEFJA E BANKËS

Italiani Mario Draghi do të zëvendësohet nga shefja aktuale e Fondit Monetar



Ndërkombëtar në krye të Bankës Qendrore Evropiane. Christine Lagarde njihet si drejtuese e FMN nga e gjithë bota. Fjala e saj ka patur peshë, qoftë për krizën e Greqisë, apo për konfliktin tregtar SH-BA-Kinë. Tani 63 vjeçarja do të bëhet presidente e Bankës Qendrore Evropiane.

Gjatë pjesëmarrjes në politikën franceze, duke filluar



që nga 2005 ndër të tjera si ministre Financash dhe e Ekonomisë nën presidentët Jacques Chirac dhe Nicolas Sarkozy - ajo bëri emër si menaxhere krizash gjatë krizës financiare botërore dhe gjatë shpëtimit të Greqisë prej falimentimit. Në takimet e nivelit të lartë të G8-s dhe G20-s, ajo ka qenë gruaja e vetme mes ministrave të tjerë të gjithë burra. Së bashku me ministrin e atëhershëm gjerman të Financave, Wolfgang Schäuble ajo krijoi në maj të vitit 2010 fondin e parë provizor për kapërcimin e krizës, i cili u krijua me garancinë e vendeve të euros.

Në fund të qershorit 2011, Lagarde u bë drejtuese e FMN, duke qenë gruaja e parë që ulet në këtë post. Që me ngjitjen në pushtet të Donald Trumpit, shefja e FMN nuk ka lenë asnjëherë rastin t'i shkojë pa folur për tregtinë e lirë botërore dhe pa paralajmëruar për rreziqet e proteksionizmit. Që prej kohës që ka qenë në qeverinë franceze, Lagarde shihet edhe si mbrojtëse e zjarrit e interesave të Francës.



KRYEDIPLOMATI

Ndërkohë, ministri i Jashtëm spanjoll, socialisti Josep Borrell, është emëruar për postin e përfaqësuesit të lartë për Çështjet e Jashtme të BE. Socialisti Josep Borrell është ministër i Jashtëm i Spanjës që nga qershori 2018. Nga 2004 deri më 2007 ai ka qenë President i Parlamentit Evropian. Studiuesi 72 vjeçar i ekonomisë, që ka edhe një master nga Universiteti amerikan Stanford, Josep Borrell është aktiv në politikën spanjolle që nga fundi i viteve 1970, kur ka mbajtur poste në ministri të ndryshme.

Nga 2010 deri më 2012 ai ka qenë President i Institutit europian të shkollave të larta në Florencë.

Ilindur në Katalanjë, Borrell është kundërshtar i bindur i ndarjes së këtij rajoni nga Spanja. Për herë të parë në një qeveri spanjolle, Borrell, i biri i një bukëpjekësi, ka marrë pjesë në vitin 1984, kur u bë sekretar shteti për çështjet financiare. Në prill 1998 ai ka qenë kandidat i socialistëve për postin e kryeministrit në zgjedhjet e vitit 2000. Por për shkak të një afere me mospagimin e taksave nga dy punonjës të ministrisë së financave, atij iu desh të hiqte dorë nga kandidimi. Ai e kërkoi fatin më pas si deputet evropian dhe nga 2004 deri 2007 ka qenë president i Parlamentit Evropian.

Zëvendësimi prej tij i Federica Mogherinit duket se do të jetë pozitiv për Shqipërinë, duke dhënë shpresë për vijimin e politikës së afritit të vendit tonë ndaj BE.

PRESIDENTI

Ndërsa është kryeministri belg ai që do të bëhet më 1

është i ngarkuar me detyrën si kryeministër i Belgjikës. Që prej zgjedhjeve parlamentare të fundit të majit, vendi me 11 milionë banorë është në kërkim të një qeverie të re.

Charles Michel, jurist, është që prej 1999 deputet në parlamentin belg dhe një kohë ministër për bashkëpunimin me vendet në zhvillim. Michel nuk është burrë i fjalëve të mëdha. Nganjëherë ai duket njeri i rezervuar. Kur Belgjika u trondit shumë pas sulmeve terroriste të marsit 2016, ai i mbledhi njerëzit pas vetes me mënyrën e tij të kujdesshme. Ka mundësi që kjo aftësi t'i shkojë mirë për shtat, kur të bëhet president i Këshillit dhe t'i duhet të ndërmjetësojë midis 28 vendeve të BE.

Michel është liberal dhe bën pjesë në grupin e partive që pas zgjedhjeve europiane iu bashkangjitën presidentit francez, Macron. Michel dha dorëheqjen nga posti i kryeministrit në dhjetor 2018, katër vjet pas qëndrimit në post, pas një grindejeje me ekstremistët e djathtë flamë lidhur me politikën ndaj refugjatëve. Politikën ai e ka marrë që në djep. I ati Louis Michel ka qenë ministër i Jashtëm në Belgjikë dhe Komisar i BE.

KRYEPARLAMENTARI

Një figurë pozitive për marrëdhëniet me



Shqipërinë duket se është përzgjedhur edhe për të drejtuar Parlamentin Evropian. Parlament zgjodhi ligjvënësin socialist italian David Sassoli për president të tij për dy vjet e gjysmë. Sassoli, 63 vjeçar, u zgjodh pas dy raunde votimesh në sesionin e parë të punës së parlamentit që doli nga zgjedhjet e muajit maj.

Sassoli, një ish gazetar nga Firenze, është deputet i Parlamentit Evropian prej një dekade.



dhjetor president i Këshillit të BE duke pasuar në post polakun Doland Tusk. Aktualisht Charles Michel

Shoqëria Përmbartimore "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme:

"Toke Are", me Nr. Pasurie 360/21 Volum 7, Faqe 82, Zonë kadastrale 3719, me sipërfaqe 2000 m², me vendodhje Vasjar, Tepelene, në pronësi të Idajet Teme Beta dtl.28.12.1958 dhe Tajane Kaso Beta dtl.03.04.1960, mbi të cilën është vënë hipotekë në favor të "Agrokredit" Sh.a, për Shumën 300,000 (treqind mijë) Leke.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 640,000 (gjashtëqind e dyzete mijë) Lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e shoqërisë "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në datë 17.07.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. "Pjetër Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë.

Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.



Shoqëria Përmbartimore "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasuritë e paluajtshme:

Are, me Nr. Pasurie 36, Vol.1, Faqe 36, Zonë kadastrale 2635 me sipërfaqe 1750 m², me vendodhje Mbrezhdan, Permet.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 140,000 (njëqind e dyzete mijë) Leke. Are, me Nr. Pasurie 269, Vol.2, Faqe 19, Zonë kadastrale 2635 me sipërfaqe 549 m², me vendodhje Mbrezhdan, Permet.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 33,600 (tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind) Leke.

Pasuritë janë në pronësi të Llazi Thoma Nasi dtl.01.10.1962, Vjollca Muharrem Nasi dtl.20.01.1971 dhe Vitori Kiço Nasi dtl.05.05.1928.

Mbi pasuritë është vënë hipotekë në favor të "Agrokredit" Sh.a, për Shumën prej 200,000 (dyqind mijë) Leke.

Ankandet do të zhvillohet në ambientet e shoqërisë "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në datë 19.07.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. "Pjetër Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.





Hapen aplikimet për Shkollën e Policisë, kriteret e dokumentat

Kandidatët do konkurojnë për 500 vende të lira. Procesi i aplikimit, deri më 3 gusht 2019, formularët tërhiqen pranë çdo Drejtorie Vendore

Hapet procesi i aplikimeve për të gjithë personat e interesuar që duan të ndjekin studimet në Shkollën Bazë të Policisë për "Patrullë të Përgjithshme". Duke filluar nga dita e djeshme procesi i aplikimit, është i hapur deri më 3 Gusht 2019, ndërsa në përfundim të të gjithë procesit të konkurimit, kuota e pranimit që do të ndjekin studimet në Akademinë e Sigurisë do të jenë 500 kursantë, të ndarë në bazë të renditjes sipas pikëve të fituara në listën e rezultateve të arritura në fazat e konkurimit.

APLIKIMI

Të gjithë garuesit, formularët e aplikimit duhet ti tërheqin pranë Drejtorive Vendore të Policisë, ku aplikanti ka vendbanimin e përhershëm, vend ky ku edhe ku duhet ti dorëzojnë.

KRITERET

Aplikanti duhet të përmbushë disa nga kriteret bazë, si të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit apo të jetë larguar nga shërbimi civil; të ketë mbaruar arsimin e mesëm; të mos

jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose të një kundërvajtjeje penale me dashje.

DOKUMENTACIONI

Ndërsa si dokumentacion, aplikantët duhet të dorëzojnë fotokopje të kartës së identitetit; dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit; certifikatë të gjendjes gjyqësore; certifikatë familjare; vërtetim nga Gjykata e Prokuroria; Raport mjeko-ligjor; e një dërë dokumentash të tjera.

FAZAT E KONKURIMIT

Për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, aplikanti i nënshtrohet disa fazave të konkurimit, si testimi me shkrim; testimi i aftësive fizike; intervistë me gojë, ushtrime vlerësuese dhe testim i aftësive të shkruarit; testimi psikologjik; kontrolli shëndetësor; marrja e shenjave të gishtave; si dhe verifikimi përfundimtar i aplikantit.

SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCESI I ANKIMIT

Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 10 ditë pune nga

mbyllja e afatit të aplikimeve. Aplikanti, që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skualifikohet duke u njoftuar me shkrim nga struktura e burimeve njerëzore. Aplikanti ka të drejtën e ankimit tek Drejtori i Policisë Vendore brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes. Drejtori i Policisë Vendore shqyrton dhe kthen përgjigje brenda 5 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

KU MUND TË MERRNI INFORMACION

Strukturat e Burimeve Njerëzore pranë Drejtorive Vendore të Policisë do t'u japin të gjithë aplikantëve formularin e aplikimit, informacionin e nevojshëm për procedurat, kërkesat dhe çdo lloj testimi e verifikimi, si dhe për ushtrimin e të drejtës së apelimit. Të gjithë aplikantët, për çdo paqartësi që mund të kenë lidhur me këtë proces, mund të drejtohen pranë strukturave të Burimeve Njerëzore në Drejtoritë Vendore të Policisë ose pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Policisë së Shtetit. Po ashtu, mund t'i parashtrijnë pyetjet apo shqetësimet e tyre dhe me e-mail në adresën: policiaeshtetit@asp.gov.al.

KRITERET E APLIKANTIT

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit apo të jetë larguar nga shërbimi civil;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;
- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- Të zotërojnë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- Të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose të një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "B".

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

- Formularin e aplikimit;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit;
- Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "B";
- Certifikatë të gjendjes gjyqësore;
- Certifikatë familjare;
- Vërtetim nga Gjykata;
- Vërtetim nga Prokuroria;
- Raport mjeko-ligjor;
- Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim që ndjek arsimin e lartë (nëse i disponon);
- Dokument të lëshuar nga institucionet shëndetësore, që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike;
- Mandat pagesa e tarifës së aplikimit.

PROCEDURA PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE

- Dorëzimi i dokumentacionit nga aplikanti dhe dhënia e numrit të regjistrimit nga struktura vendore e burimeve njerëzore;
- Shqyrtimi i kriterëve dhe dokumentacionit nga struktura vendore e burimeve njerëzore, nëse aplikanti plotëson kriteret e përcaktuara;
- Verifikimi paraprak i aplikantëve, për rekorde të mundshme kriminale;
- Njoftimi me shkrim nga struktura vendore i aplikantëve, që nuk plotësojnë kriteret për të vazhduar testimin;
- Dërgimi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore i listës emërore të aplikantëve, që plotësojnë kriteret e përcaktuara;
- Hartimi i listës përfundimtare të aplikantëve, që plotësojnë kriteret dhe kaktimi i kodit për çdo aplikant nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore;
- Pajisja e çdo aplikanti me formularin e pranimit dhe numrin personal nga strukturat vendore të burimeve njerëzore;
- Publikimi në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit dhe në media për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të konkurimit, si dhe listën e kandidatëve që kualifikohen për të konkuruar;
- Procesi i apelimit;
- Konkurrimi.

FAZAT E KONKURIMIT

- Aplikanti, që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të mëposhtme të konkurimit:
- Testimi me shkrim;
- Testimi i aftësive fizike;
- Intervistë me gojë, ushtrime vlerësuese dhe testim i aftësive të shkruarit;
- Testimi psikologjik;
- Kontrolli shëndetësor;
- Marrja e shenjave të gishtave;
- Verifikimi përfundimtar i aplikantit.



NJOFTIM

Shoqëria Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-3, të pasurisë së paluajtshme në pronësi të z.Ibrahim Pellumbi, lënë garanci për "Credins Bank" sh.a.

-Në datë 11.07.2019 ora 16:00.
 -"Are" Pasuri nr. 198/1, Vol.6, Fq.127, ZK.2947, me sip.400 m², me adrese Petrele, Tirane, ne pronesi te z. Ibrahim Pellumbi, me çmimin fillestar 1,512,000 Leke.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com



NJOFTIM

Shoqëria Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-3, të pasurisë së paluajtshme në pronësi të z.Bujar Nurka dhe znj.Luljeta Nurka me pale kreditore "Credins Bank" sh.a.

-Në datë 29.07.2019 ora 16:00.
 -"Kullote" Pasuri nr. 1/671, Vol.5, Fq.223, ZK.2297, me sip.66,465 m² me adrese Ksamil, Sarandë, ne pronesi te z.Bujar Nurka dhe znj.Luljeta Nurka, me çmimin fillestar 2,344,885 Euro.
 -"Kullote" Pasuri nr. 1/670, Vol.3, Fq.218, ZK.2297, me sip.83,535 m² me adrese Ksamil, Sarandë, ne pronesi te z.Bujar Nurka dhe znj.Luljeta Nurka, me çmimin fillestar 2,947,115 Euro.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com

VKM, ndryshojnë rregullat për kreditë me interes të ulët

Sa përfitojnë familjet që marrin banesë me kosto të lirë me ndihmë nga shteti

Ndryshojnë rregullat për përcaktimin e kredive me interes të ulët që mund të marrin familjet për banesa, me ndihmë nga shteti.

Këshilli i Ministrave ka vendosur ditën e djeshme masën e subvencionit, kush e përfiton dhe institucionet që do të merren me verifikimin e procesit.

SUBVENCIONI

Në VKM përcaktohet se masa e subvencionit të interesave të kredisë për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti, për banesa me kosto të ulët, bazuar në ligjin nr.22/2018, "Për strehimin social", do të jetë e barabartë me diferencën që rezulton ndërmjet interesit vjetor të kredisë në tregun e lire, me interesin në varësi të aftësisë përballuese të familjes, me kusht që interesi dhe principli që paguan familja të mos jenë më të mëdha se aftësia e familjes për t'i përballuar.

Në rastet kur këstet mujore me interes të subvencionuar rezultojnë më të larta se aftësia e familjes për t'i përballuar ato, familja kalon për trajtim në një program tjetër të përballueshëm për të.

Llogaritja e masës së subvencionit të interesave të kredisë do të bëhet në momentin e lidhjes së kontratës për marrjen e kredisë, ndërmjet individit/familjes përfituese dhe institucionit financiar, mbështetur në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet institucionit financiar dhe ministritë përgjegjëse për strehimin ose njësies së vetëqeverisjes vendore.

Përjashtim bëhet vetëm për familjet qiramarrëse që banojnë në banesa, pronë e subjekteve të shpronësuara, të cilat përfitojnë subvencion 100% të interesit të kredisë. Këto familje paguajnë vetëm principalin e kredisë me interes 0%.

KUSH PËRFITON

Procedura e dhënies së subvencionit të interesave të kredisë për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi fillon me përzgjedhjen e institucionit financiar që do të kreditojë familjet. Përzgjedhja e institucionit financiar, që do të kreditojë familjet, bëhet me procedurë konkurrimi nëpërmjet një oferte publike dhe transparente ftohen të gjitha institucionet financiare, që kryejnë shërbime për dhënie e kredive në territorin e Republikës së Shqipërisë; oferta publike shoqërohet edhe me kriteret për vlerësimin e ofertës fituese. Vlerësimi i ofertave duhet të marrë parasysh kostot më të ulëta për buxhetin dhe kostot më të përballueshme për familjet.

KËRKESAT

Individi/familja që aplikon për subvencionimin e interesave të kredisë paraqet në

Përballimi

Në rastet kur këstet mujore me interes të subvencionuar rezultojnë më të larta se aftësia e familjes për t'i përballuar ato, familja kalon për trajtim në një program tjetër të përballueshëm për të



Tjetërsimi

Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t'i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë te një individ tjetër ose ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë



strukturën përkatëse të njësies së vetëqeverisjes vendore dokumentacionin që lidhet me plotësimin e kushteve të përgjithshme. Lista e familjeve që plotësojnë kushtet e subvencionimit të interesave të kredisë miratohet me vendim të këshillit të njësies së vetëqeverisjes vendore.

Miratimi, me vendim të këshillit të njësies së vetëqeverisjes vendore, ilitës së familjeve që plotësojnë kushtet për subvencionimin e interesave të kredisë, nuk e bën familjen automatikisht përfituese. Institucioni ndjek të gjitha procedurat e veta për përfitimin e kredisë dhe verifikon aftësinë përbal-

luese të individit/familjes, mbështetur në të ardhurat që kanë, me qëllim që përfituesi të zgjedhë në treg për blerje me kredi një banesë që i përshkruhet kushteve specifike të tij. Institucioni financiar bën vlerësimin për banesën e zgjedhur dhe aftësinë për ta përballuar shlyerjen e kësteve të kredisë nga përfituesi, mbështetur në programin e subvencionimit të interesave të kredisë.

DOKUMENTAT

Për efekt të përfitimit të subvencionimit të interesave të kredisë, individët/familjet, që janë miratuar me vendim të këshillit të njësies

së vetëqeverisjes vendore, paraqiten pranë strukturës përgjegjëse për strehimin në njësien e vetëqeverisjes vendore për të bërë deklaratën për dhënie e pëlqimit për përdorimin e të dhënave personale, me qëllim rifreskimin e dokumentacionit që lidhet me vërtetimin negativ nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nuk figuron, në të gjithë territorin e Shqipërisë, pronë e regjistruar ose në proces regjistrimi ose vërtetimin për një pronë që është nën normat e banimit; vërtetimin nga bankat për gjendjen e llogarive dhe të depozitave të familjes/individit; dokumentin e lëshuar nga këshilli i njësies së vetëqeverisjes vendore për dhënie e statusit të individit/familjes që përfiton për subvencionimin e kredisë; certifikatën e gjendjes familjare; adresën e banesës dhe emrin e pronarit të banesës.

BANESA

Individët/familjet e miratuar me vendim të këshillit të njësies së vetëqeverisjes vendore duhet të kujdesen për gjetjen e një banese për blerje me kredi dhe kanë një afat 6-mujor nga data e marrjes së njoftimit për lidhjen e kontratës me institucionin financiar. Në rast se pas kalimit të këtij afati individ/familja ende nuk ka gjetur banesë, paraqitet pranë institucionit financiar dhe institucionit që monitoron subvencionin e kredisë për të kërkuar shtyrje të afatit.

Kur familja paraqitet pranë institucionit financiar dhe institucionit që monitoron subvencionin e kredisë brenda 6 muajve nga data e njoftimit (publik/shpallja e listave/me shkresë), duke kërkuar shtyrje të afatit, emri i subjektit vazhdon të qëndrojë në listë pritjeje edhe për 6 muaj të tjerë.

Në rast se familja nuk paraqitet brenda 6 muajve dhe as ka kërkuar shtyrje të afatit, veprohet, si më poshtë vijon: kur nga njësia e vetëqeverisjes vendore janë dërguar



lista rezervë, sipas pikës 21, të këtij vendimi, institucioni financiar vijon me listën emërore rezervë; kur lista rezervë është shtruar, njësia e vetëqeverisjes vendore harton listën e radhës me subjekte që plotësojnë kriteret ligjore dhe janë renditur më poshtë me pikë.

INTERESI ZERO

Individët/familjet përfituese të kredisë me interes 0%, që janë qiramarrës në banesa pronë e subjekteve të shpronësuara, duhet të paraqesin një deklaratë pranë nepunësit të institucionit publik, të ngarkuar nga qeveria, në përputhje me rregullimet e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.3/2012, të Këshillit të Ministrave, që ai dhe familja e tij pranojnë të lirojnë banesën e pronarit brenda 30 ditëve, nga data e lëvrimin të kredisë, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjen me pronarin/pronarët. Institucioni financiar nuk lidh kontratën me përfituesin në mungesë të deklaratës së mësipërme.

SHLYERJA

E drejta e shlyerjes së kredisë nuk mund t'i kalojë një personi tjetër. Në rast se familja, për shkaqe ekonomike, nuk mund të vazhdojë më shlyerjen e kredisë, njofton menjëherë institucionin financiar dhe njësien e vetëqeverisjes vendore përkatëse. Për çdo rast bëhet vlerësimi i shumës së shlyer nga familja, subvencionimit të interesave të kredisë, që ajo ka përfituar nga shteti, dhe pjesës së ngelur të kredisë. Në marrëveshje ndërmjet institucionit financiar, familjes dhe njësies së vetëqeverisjes vendore mund të jepet njëra prej zgjidhjeve të mëposhtme: familja mund t'i kalojë të drejtën e shlyer-

jes së kredisë një familjeje tjetër, që është në listën e njësies së vetëqeverisjes vendore dhe përmbush të njëjtat kriteret për përfitimin dhe shlyerjen e kredisë. Mënyra e kalimit të kësaj të drejte dhe marrëdhëniet ndërmjet dy familjeve rregullohen me akt noterial mes palëve të interesuara; banesa mund të kalojë në pronësi të njësies së vetëqeverisjes vendore vetëm kur kjo e fundit merr përsipër shlyerjen e detyrimeve që i takon familjes në mënyrë të menjëhershme ose me kredi, sipas plan – pagesave të familjes. Në këtë rast, familja kalon me kontratë qiraje sociale me njësien e vetëqeverisjes vendore dhe subvencionimi i interesave të kredisë nga buxheti i shtetit ndërpritet. Nëse nuk plotësohet asnjë nga dy alternativat e mësipërme, banesa vlerësohet dhe shitet në ankand, sipas procedurave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile.

NDËRPRERJA

Institucioni, që zbaton programin, njofton institucionin financiar për ndërprerjen e subvencionimit të interesave të kredisë kur, nga verifikimet, qofshin rastësore ose jo, bazuar në ankesa apo denoncime të individëve a institucioneve, konstatohet se qytetari nuk ka liru banesën e pronarit brenda afatit të përcaktuar; ka falsifikime të dokumenteve apo deklaratat të rreme.

TË DREJTAT

Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t'i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë te një individ tjetër ose ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë.

Vendimi është parashikuar të hyjë në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".



NJOFTIM

Shoqëria Përmbarimore "Bailliff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-1, të pasurive të paluajtshme në pronësi të shoqërisë "Alumix" sh.p.k me pale kreditore "Alpha Bank" sh.a

-Në datë 09.07.2019 ora 16:00.
 -"Apartament" Pasuri nr. 8/483+2-22, Vol.22, Fq.232, ZK.8120, me sip.112.7 m² me adresë Rr. "5 Maji", Korpusi B, Ap.22, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 60,800 Euro.
 -"Apartament" Pasuri nr. 8/483+1-11, Vol.22, Fq.179, ZK.8120, me sip.68.6 m² me adresë Rr. "5 Maji", Korpusi B, Ap.11, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 38,000 Euro.
 -"Garazh" Pasuri nr. 8/483-G3, Vol.22, Fq.180, ZK.8120, me sip.160 m² me adresë Rr. "5 Maji", Korpusi B, Garazh nr.3, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 49,760 Euro.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com

Shkaktoi aksidentin me 3 viktima Devoll, ja sa alkool kishte pirë autori i krimit


Ngjarja ku humbën jetën dy gra dhe një fëmijë, Olsi Belortaja sot para gjykatës

ELTON QYNO
TIRANE

Olsi Belortaja, agjenti doganor që shkaktoi aksidentin e rëndë me tre viktima në Bilisht, ka qënë i dehur dhe kjo është vërtetuar nga dy teste alkoolike që policia i ka bërë. Belortaja pritet të dalë nesër përpara gjykatës së Korçës dhe prokurorit Julian Kristo, ku do përballen tre akuza të ngritura. Drejtuesi i mjetit rezultoi të kishte pirë alkool dhe gjatë testit nga policia ka rezultuar se ka qënë në masën e 0.85 mg/l dhe 0.82 mg/l. "Shqiptarja.com" zbardh të plotë dinamikën e aksidentit të rëndë në Kapshticë dhe momentin e arrestimit të Olsi Belortasë në fshatin Zëmlak të Korçës.


NGJARJA ME 3 VIKTIMA

Sipas materialit hetimor në 30 qershor 2019, rreth orës 18:30, Olsi



Belortaja, ishte duke qarkulluar me automjetin e tij të markës Benz me targë KO 775 OB në rrugën nacionale Kapshticë-Bilisht. Në një pjesë të kësaj rruge, konkretisht në kryqëzimin e saj me rrugën e

fshatit Kapshticë ishin duke udhëtuar si këmbësorë Anjeza Gani, Valmira Çuko dhe Semi Çuko. Në këtë vend, automjeti i drejtuar nga Olsi Belortaja ka humbur kontrollin dhe ka goditur këmbësorët



Anjeza Gani dhe Valmira Çuko, të cilët kanë ndërruar jetë menjëherë pas aksidentit dhe ka goditur fëmijën e mitur Semi Çuko, të cilin e ka plagosur rëndë por më pas ka ndërruar jetë në një spital në Tiranë. Menjëherë pas aksidentit Olsi Belortaja është larguar nga vendi i ngjarjes dhe më pas është kapur në afërsi të fshatit Zëmlak nga punonjësit e Policisë Gjyqësore.

SA ALKOOL KISHTE PIRË AUTOR I KRIMIT

Në vendin e aksidentit janë mbledhur shumë persona, të cilët u ndodhën rastësisht në vendin e ngjarjes dhe më pas kanë dërguar viktimat nga aksidenti për në Spitalin Rajonal Korçë. Ndërkohë në momentin e kapjes në flagrancë Olsi Belortaja, i është kryer nga ana e punonjësit të policisë dy herë testin e alkoolit

me aparat drager dhe ka rezultuar që Olsi Belortaja kishte konsumuar alkool në masën 0.85 mg/l dhe 0.82 mg/l. Në këto kushte oficerët e policisë gjyqësore kanë kryer arrestimin në flagrancë të këtij personi. Nga ana e Policisë Gjyqësore është vendosur kryerja e ekspertimeve mjeko-ligjore dhe autoteknike për ngjarjen e mësipërme. Nga sa më sipër, krijohet dyshimi i bazuar në prova se në faktin e mesipërm gjenden elementet e veprës penale të "Largim nga vendi i aksidentit", pasi Olsi Belortaja është larguar nga vendi i ngjarjes me qëllim që të shmangte përgjegjësitë që rridhnin nga ky aksident, "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" me pasojë vdekjen e tre personave dhe "Drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt" pasi Belortaja ishte duke drejtuar një automjet në gjendje të dehur.

VENDIMI I GJYKATËS

U kap me 200 mijë lekë në dorë, specialistja e hipotekës Devoll shpallet e pafajshme

Valbona Beshi, një ish-specialiste e Hipotekës së Devollit, e vënë nën akuzë nga prokuroria e Korçës për korrupsion, ka arritur të marrë pafajësinë në gjykatën e këtij qyteti. Vendimi i pafajësisë është dhënë sot nga gjyqtarja, Flojera Davidhi, e cila ka konstatuar se rasti në fjalë nuk hynte në çështjet e karakterit penal, e për pasojë ka rrëzuar kërkesën e prokurorisë për dënimin e Beshit, duke vendosur të deklarojë të pafajshme ish-zyrtaren e hipotekës. Gjatë seancës gjyqësore mësohet se Beshi është përlotur para trupit gjykues. Rasti korruptiv, fillimisht është ndjekur dhe denoncuar nga emisioni "Fiks-Fare", ku pas publikimit të materialit filmik, ku Valbona Beshi, i merte një qytetari një sasi prej 200 mijë lekësh, çështjen e ka marrë në dorë prokuroria e Korçës. Kanë mjaftuar disa muaj hetime nga prokuroria e Korçës, dhe prokurori i çështjes Gentian Stoja, ka proceduar me dërgimin

e materialit hetimor në gjykatë, ku e pandehur është marrë Valbona Beshi, ish-specialiste hartografie në hipotekën e Devollit. Beshi ka hyrë në këtë gjykim me procedurën e gjykimit të shkurtuar. Prokurori Stoja i kërkoi trupit gjykues dënimin e Beshit, me 2 vite burgim për akuzën e korrupsionit, masë dënimi kjo që

sipas prokurorit të konvertohej në shërbim prove. Por pas tërheqjes së trupit gjykues, gjyqtarja Flojera Davidhi, ka vendosur të deklarojë të pafajshme. Pritet që ky vendim të apelohej shumë shpejt në Gjykatën e Apelit në Korçë, ku do kërkohet dënimimi me 2 vite burgim për Valbona Beshin.

NGJARJA NË KORÇË

Ish-kandidatja për Këshillin Bashkiak shtypi 2 të rinj shqiptarë me makinë, 5-fish e dehur mbi normën e lejuar



Ergi Skënderi dhe Xhulio Kaya ishin dy miq të ngushtë me njëri-tjetrit, të cilët gjatë fundjavës kaluan një mbrëmje të bukur në një prej diskove në Piacenza, mbrëmje e cila u shndërrua në një tragjedi. Sapo dolën nga disko, rreth orës 04:00 të mëngjesit,

një makinë me shpejtësi të lartë i goditi ata për vdekje. Mjeti drejtohej nga Irena Vetere, 30-vjeçarja, e cila siç raportojnë mediat italiane, ishte e dehur, 5 herë më lart nga norma e lejuar. Teksa tentoi për t'i shmangur, ajo përfundoi në kanal, duke marrë

lëndime serioze, si dhe është në masën e arrestit. Irena Vetere me origjinë nga Rusia, por shtetase italiane, ka qënë kandidat për Këshillin Bashkiak. Mësohet 30-vjeçarja i është hequr patenta disa herë, pikërisht për shkak se drejtonte mjetin e dehur.



Policia ofron 10 mijë euro shpërblim për kapjen e grabitësve të Rinasit

Policia e shtetit kërkon informacion për arrestimin e personave kryesorë të grabitjes

Policia e Shtetit ofron 10 mijë euro shpërblim për kapjen e Klement e Eldi Çalës, si dhe Talo Çelës të shpallur në kërkim lidhur me grabitjen e ndodhur në Rinas në 9 prill të këtij viti ku u morën miliona euro në pak minuta dhe mbeti i vrarë Admir Murataj. Ajo ofron në dispozicion dy numra duke premtuar anonimata të plotë për informatorët. "Cilido qytetar që disponon informacion të vlefshëm, të telefonojë në numrat: 069 41 04 111 dhe 069 41 00 615, duke iu garantuar anonimata të plotë e të sigurt"-thuhet në njoftimin e policisë. Nga grabitja e ndodhur në Rinas në 9 prill janë vënë Ragip Hajdini, Elton Pikli, Renaldo Sulaj, Oltjan Veseli, Saimir Cela dhe Alkond Bengasi. Dëshmia e këtij të fundit zbuloi grupit, duke pranuar të bashkëpunojë me drejtësinë. Më 15 qershor të këtij viti policia vuri në pranga edhe Hasan Kanaçin, personin që informoi grabitësit nga brenda aeroportit. Ndërsa gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij u gjetën rreth 100 mijë euro, të konvertuara

në kartmonedha të ndryshme, për të cilat ka dyshime të forta se i përkasin shumës prej 4.6 milionë eurove të grabitura në Rinas më 9 Prill dhe të cilat do të transportoheshin me avion nga Shqipëria drejt Vjenës. Pas ngjarjeve në datë 20 prill policia mori kontrollin në sallën e kamerave duke nisur zbatimin e masave shtesë.

4.6 MILIONË EURO

Policia dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda zbulojnë informatorin e grupit kriminal që realizoi supergrabitjen e miliona eurove në 9 prill, brenda aeroportit të Rinasit. Në pranga ka rënë Hasan Kanaçi, i cili mbante detyrën e agentit të cargos, në aeroportin Nënë Tereza. Arrestimi i 48 vjeçarit është mbremjen e djeshme në banesën e tij në Tiranë. Ndërkohë gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij u gjetën rreth 100 mijë



euro, të konvertuara në kartmonedha të ndryshme, për të cilat ka dyshime të forta se i përkasin shumës prej 4.6 milionë eurove të grabitura në Rinas më 9 Prill dhe të cilat do të

transportoheshin me avion nga Shqipëria drejt Vjenës. Kanaçi ishte agjenti që merrej me ngarkesën e vlerave monetare në aeroport dhe kishte dijeni për oraret fikse se kur vlerat monetare

mbërrinin e futeshin në barkun e avionit. Lidhur me këtë fakt, grupi hetimor ka dyshime të forta se 48-vjeçari ka njoftuar grupin kriminal për orarin e lëvizjet që do të bënin automjetet që po

transportonin shumën e parave.

AKUZAT PËR KANAÇIN

Mbi Kanaçin rëndojnë akuzat "Vjedhje me armë kryer në bashkëpunim", "Grupi i strukturuar kriminal", "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të ftohta", "Mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municioneve luftarake", "Vrasje e punonjësve të Policisë së Shtetit" e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativa. Kanaçi është personi i 7 që përfundoi në pranga lidhur me grabitjen e milionave euro në aeroportin e Rinasit. Më herët në pranga janë vënë Ragip Hajdini, Elton Pikli, Renaldo Sulaj, Oltjan Veseli, Saimir Cela dhe Alkond Bengasi. Dëshmia e këtij të fundit zbuloi grupit, duke pranuar të bashkëpunojë me drejtësinë. Ndërkohë që në kërkim vijojnë të jenë vëllezërit Klement e Eldi Çala, si dhe Talo Çela. Ditën e ngjarjes, gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë, mbeti i vrarë edhe organizatori Admir Murataj. Pas ngjarjeve në datë 20 prill policia mori kontrollin në sallën e kamerave duke nisur zbatimin e masave shtesë.

POROSIA E FUNDIT

Kanabis në makinë e në magazinë, kapen tre persona në Kavajë

Tre persona janë vënë në pranga nga policia e Kavajës pasi janë kapur me 11,7 kg kanabis. Tre të arrestuarit janë Muharrem Kërçuku, 23 vjeç, lindur dhe banues në Kavajë, Orges Leka 25 vjeç, lindur dhe banues në Divjakë si dhe E. M. 40 vjeç, lindur dhe banues në Divjakë. Personat në fjalë janë arrestuar

në kuadër të operacionit "Porosia e Fundit", ku si fillim u kap në flagrancë Muharrem Kërçuku, 23 vjeç, ku gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin e tij, iu gjet një sasi prej rreth 1 kg lëndë narkotike kanabis, si dhe një sasi lekësh që dyshohet se janë përfituar nga shitja e lëndës narkotike, dy aparate

celulare që përdorehin për të siguruar klientelë, si dhe një automjet që mundëson të shpërndarjen e lëndës narkotike. Operacioni më tej ka vijuar në bashkëpunim me Komisaratin e Policisë Divjakë, në fshatin Çermë, ku u bë arrestimi i Orges Leka, 25 vjeç, pasi gjatë kontrollit në magazinën e tij afër ven-

dit ku banonte, iu gjet dhe iu sekuestrua një sasi prej rreth 10,7 kg lëndë narkotike kanabis. Po në kuadër të operacionit, u bë dhe kapja e Edison Malki, 40 vjeç banues në Zharnec-Divjakë. Të arrestuarit do të përballen me akuzën e "Prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike" kryer në bashkëpunim.



Analizohet operacioni policor antidrogë i koduar "

LAJME SHKURT

Drogë me furgon drejt Malit të Zi, goditet grupi kriminal me kapon nga Shkodra

Një grup i strukturuar kriminal i cili merrej me trafikim të lëndëve narkotike nga Shqipëria drejt Malit të Zi është shkatërruar ditën e djeshme, ku në pranga kanë rënë 5 anëtarë të tij. Bëhet me dije se janë arrestuar Zef Kola, Genc Mecaj, Kristjan Melaj, Elvis Hysaj dhe Xhusepe Delaj si dhe është sekuestruar një sasi prej 205 kg marijuanë. Mësohet se ky grup kryente organizimin, financimin, transportin dhe

trafikimin marijuanës nga qyteti i Koplikut në drejtim të Malit të Zi dhe më gjerë dhe secili prej anëtarëve kishte një rol të rëndësishëm. Sasia e drogës që u sekuestrua po transportohej drejt Malit të Zi nga Zef Kola, që ishte dhe koka e kësaj bande në bashkëpunim me Genc Mecaj. Në përfundim të operacionit u sekuestruan 205 kg lëndë narkotike, 5 automjete që përdorehin për transportin e drogës dhe 5 telefona celularë.



Ngjarja, u fut për t'u larë në lumë me shokët, mbytet 17 vjeçari në Itali

Një 17-vjeçar nga Shqipëria ka humbur jetën në mënyrë tragjike në Itali menjëherë sapo ka hyrë për t'u larë në ujërat e lumit Chiusella. Ngjarja ndodhi rreth orës 13.30 të ditës së djeshme teksa po futej të lahej në lumë bashkë me dy të rinj të tjerë bashkëkombas të tij. Miqtë e tij lajmëruan menjëherë autoritetet të cilat shkuan në vendngjarje por tashmë i riu kishte ndërruar jetë. Ekipet e zhytësve nxorën trupin e tij të pajetë.



SSSS



PERIFERI



NGA Alba MALLTEZI

A do të largojnë Rudina e Glauku enveristët e fundit nga PD?

Po më quajtitë tradhëtar, nuk mërzitem”. Kështu e përfundoi statusin e tij Glauk Oldashi, me mendimin e sinqertë për Partinë Demokratike, ku babai aderoi dhe besoi. Glauku është ende i ri, por dëshirën për të kontribuar në politikë e ka shprehur. Glauku, si dhe Rudina Hajdari janë fëmijë që janë rritur me bukë dhe politikë, por ndoshta, paparashikueshëm, janë rritur edhe me edukatë, mirësjellje dhe liri. Mund të jenë shkollat, familja, vetvetja, Perendimi, nuk e di se cili është mielli real i formimit të tyre, por këta dy të rinj sot janë këta që shohim, janë ndryshe. Të drejtpërdrejtë në artikullimin e tyre, por gjithnjë me një

mburojë që e mbajnë me vete për t'u mbrojtur në çdo rast nga shigjetat e gojëve të liga që nuk pranojnë mendimin alternativ. Tamam siç do të ndodhte në kohën e Enverit: Linçim publik dhe kolektiv ndaj të ndryshmëve. Sa herë e kemi shkruar dhe pretenduar më parë: Shqipëria dhe shqiptarët nuk mund të vazhdojnë të durojnë akoma më gjatë gjuhën e shpifjes, të agresivitetit, të denigrimit apo gjuhën seksiste që lider-shipi i vjetër i Partisë Demokratike solli dhe rrënjosi duke kalbur përgjithmonë ëndrrat dhe idealet në PD. Një turmë pa sy dhe pa tru, që në shesh dhe nëpër rrjete sociale imiton dhe shumfishon gjuhën e tyre dhe dhunën e liderit, nuk ka rrugë tjetër veç izolimit dhe fatit të

zi të shuarjes përgjithmonë. Nga balta e plehu lindin zambakë të bardhë, thotë një shprehje e moçme aziatike dhe kjo do të ndodhë me siguri edhe në baltën më të pisët që ka prodhuar politika jonë. Dhe integrimi ynë në botën e qytetëruar parashikon edhe vyshkjen e më të fundit mentalitet enverist të gjyqeve popullore, prokurorëve pa avokatë, sigurimsave, persekutorëve, denigruesve, parazitëve që nën petkun e “Demokratëve” jetuan pa u shqetësuar deri më sot. Rudina Hajdari dhe Glauk Oldashi, e shumë të rinj me mentalitet perëndimor, janë shpresa për një demokraci reale, të barabartë, e konkurruese. Do të vijë kjo ditë në Shqipëri e do të dalin të rinj ndryshe. Nuk ka ku të shkojë.



ANALIZA

Libri dëgjohet



NGA EDISON YPI

Nga britma e parë kur sapo bie nga barku i nënës deri te traku i fundit i zemrës, e gjithë jeta është muzikë. Për gjithkënd që nuk e njeh Letësinë, Artin, por edhe zeje, nuk thuhet “nuk merr sy” apo “nuk merr hundë”, por “nuk merr vesh”, pra nuk dëgjon muzikat përkatëse. Me gjasë, rilindasit që ishin seriozë dhe “merrnin vesh” nga shumëçka, ata duhet të falenderojmë për këtë dhuratë linguistike që zor se ka të dytë në botë për të shquar injorantët. Muzika është e kudondodhur. Muzika, rrëmuja më e rregullt që ekziston, as nuk ikën as nuk vjen. Aty ka qënë, është, e do të jetë. Nuk ka skutë në botë pa muzikën e vet. Muzika është oqeani ku është mbytur bota. Edhe boshi dhe heshtja e pafund e Kozmosit ka muzikën e vet. Muzika nuk është si librat që kanë rend, fillim, vazhdim, mbarim. Në oqeanin e muzikës mund të hidhesh e të mbytesh në çdo çast e nga çdo breg.

Hingëllima kuajsh. Britma jeniçerësh. Gërrvima qerresh që

ikin duke ngitur pluhur grahur nga kasnecë me fermanë perandorakë në gji ose koka të prera në arka me akull për të mos u kalbur. Lutje muzeinësh mbi minare. Kanconeta që memzi dëgjohe në magnetofona të vjetër me shirita që vazhdimisht këputen dhe broduejsat vazhdimish i ngjitin. Pëshpërma të rrezikshme të deklasuarish nëpër bodrume që bëjnë shakara të kripura, shqiptojnë herezira të frikshme, dhe presin rrëzimin e pushtetit të vrasësve. Qeflinj mikrob-orgezë që për t'ju dukur gruaja më joshëse e shohin fshehtas nga brima e çelësit në dush nën muzikën e ujit që gruas i lëpin kurmin. Sherr mes komitësh mokrarë lidhur me vargjet e këngës “Ta sulmoj Trebinjën” nëse vazhdimi është “bytha nuk ma mban” apo “bytha ma mban”, derisa dikush i zbut gjakrat duke u thënë të mos sherrosen kot se “kënga është tjetër gjë”. Gurgullima përrrenjsh të rrezikshëm. Heshtje uluritëse malësorësh nëpër hane që janë nisur të marrin gjak. Krisma gjaksish. Furra elektrike të uritura për çelik që “hungërrijnë si luanë” etj. etj. Romanet e Kadaresë janë tekst, por përplot me muzikë. Aq shumë muzikë, sa më tepër dëgjohe në lexohen.

“Ti qan që larg”, “do të buças në krisma jete”, “shkrepe me zjarr porsi shkëndia”, “rrufe që pat dërmuar”, “do buçasë një yll së brendi”, etj. etj. për habinë dhe fatkeqësinë e atyre që për Poezinë të shurdhojnë veshët por nga Poezia “nuk marrin vesh”, Poezitë e Lasgushit, ja ato të qetat e të ëmblat në dukje, janë përplot me krisma, buçima, ulurima.

Si drita që është njëkohësisht valore dhe grimcore, Arti është edhe

shqisor edhe subjektiv. Prandaj Arti nuk është kurrë vetëm Alfabet, vetëm pentagram, vetëm penel, vetëm daltë, por gjithmonë një ekuilibër delikat, një kombinim divin, Alfabet plus pentagram, ose daltë plus penel plus aromë, etj. Fakti që këtë ekuilibër arrijnë ta realizojnë vetëm gjenialët, është arsyeja pse jo gjithçka që shkruhet, pikturohet, dëgjohet, nuhatet, është Art.

Arti si shkak i thellë dhe i hollë shqisash, dhe pasojë veglash, është një produkt pafundësisht kompleks.


Arti quhet Letërsi ose Muzikë ose Pikturë, në varësi se cilën shqisë zgjon, alarmon, ekzaltin, më tepër. Nëse artisti më së shumti përdor Alfabet, nota, ngjyra, daltë, quhet respektivisht Letërsi, muzikë, pikturë, skulpturë, etj.

“Aromë Gruaje” është një nga pararendësit letrarë dhe filmikë të artit të Aromës, Artit më të vjetër që ende nuk ka emër se është në fillimet e tij por së afërmi, kur ulur në kolltuk duke parë një film do provojmë dhe aromën përkatëse, do marri hov me ndihmën e teknologjisë.

Muzika pra, nuk del vetëm nga teli i violinës, gryka e gajdes, brima et e fyellit, hinka e saksofonit, por edhe nga pena e shkrimtarit, peneli i piktorit, dalta e skulptorit.

Teksti dëgjohet, muzika shikohet, piktura nuhatet, skulptura lexohet, nuk janë pohime paradoksale. Tingulli i telit apo bumi i daulles, janë vetëm maja e ajsbergut zhytur thellë në oqeanin e shpirtit.

Për sa kohë çdolloj vegle që nxjerr një muzikë të këndëshme e ekzaltin shpirtin cilësisht njësoj si orkestra me treqint violina, është e qartë se nuk janë të rëndësishëm tingujt në



vetvete, por alternimi i kohëzgjatjes së tingujve me kohëzgjatjet e pauzave, në atë mënyrë që të hapin e të mbyllin në tru ato rrugë gjaku që muzika të mos jetë deprimente por relaksuese.

Nuk ka Letërsi pa muzikë, Muzikë pa aromë, skulpturë pa tekst. Nuk ka kryevepër pa të gjitha ndjesitë bashkë. Pikërisht sepse arti është mpleksja e shqisave, autorët nuk dinë ta qartësojnë laboratorin për të cilin thonë se e marin në varr. Laboratori i artistit është e gjirhë bota. Nuk mund të marret bota në varr. Sado gjenialë, duke qënë një kokrrizë në kozmosin e pafund, thjesht nuk e spjegojnë dot.

Rasti i Jean-Baptiste Grenouille, protagonistit të romanit “Parfumi” që kishte nuhatje fenomenale pikërisht sepse brenda vetes nuk kishte asnjë aromë, është një provë se Arti është irracionale sepse me vështirësi “merret vesh”, por nuk është aspak paradoksal.

Libri, lokomotiva e arteve, jo vetëm lexohet. Libri më së paku lexohet. Libri dëgjohet. Libri imagjohet.

Libri sigurisht edhe nuhatet. Libri ka brenda vetes pafund tinguj, aroma, imazhe. Nga Libri “të marrësh vesh”, pra librin të dish ta dëgjosh, është ndoshta po aq e vështirë dhe e rrallë sa të dish ta shkruash.

Leximi dhe dëgjimi i librit janë ekzaltimi i brendshëm i pakonkurrueshëm.

Para Librit dhe Letërsisë roboti do mbetet një dallamango i ngathët dhe kompjuteri një budalla i hekurt.

Në pritje të na çfaqet një tjetër virtuoz që të shqyrtojë lidhjen e letërsisë me aromën, një i dytë atë të mardhënies mes arkitekturës dhe letërsisë, një i tretë të skulpturës me matematikën, të falenderojmë përunjësisht akdamikun perfeksionist estetizant Vasil Tole për librin “Kadare dhe Muzika”, këtë kontribut kolosal në hulumtimin e llagëmeve labirintike mes Letërsisë dhe Muzikës përmes veprës letrare beethoveniane, mozartiane, lokale, kontinentale, botërore, kozmike, të Kadaresë.

Paradë

FJALËKRYQESH

FJALËKRYQESH



NGA
KADRI
VOKOPOLA

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHETTË NXINI **36** KUTI[illegible]

HORIZONTAL

1. Diana e grekëve.
-Iniciale e Lucas regjisor.
-Fletë pa kufij.
2. Charles in përrallave.
-Basic Utility Vehicle.
-Mbyllin akte
3. Janë efektet e padëshirura të llaçeve.
-Një vështrim... rrethinash
4. Film i Akira Kurosawa-s.
-Është degë e mekanikës që përshkruan lëvizjen e trupave.
5. Ekberg që ajo labe.
-E famshme qjo aktore.
6. U shkrua nga Ovidi.
7. Derisa janë në fund.
-Janë gjurmët e meteoriteve.
-Pak pirografi.
8. Është ishull i Cikladeve.
-Janë ara të pambjella.
9. Lee regjisor.
-Kryeqyteti i sauditëve.
-Një vijë e lakuar.
- Një pjesë e monotonisë.
10. Një i lindur në Palestinë.
-Është diletanit
-Mund të jetë kuzhine.
11. Janë binarët.
-Janë si halla
-Bezani aktor.

12. Është si nofkë.
-Një pjesë e lartësisë.
-Skywalker i Star Wars.
-Kush merr... digjet

VERTIKAL

1. Një mund të jetë fotografik.
-Mendes regjisor.
2. Ka shkruar Jeta e Jezusit.
-Para Diego në Kaliforni.
-Ekstremitë në trup.
3. Mund të jetë mallrash.
-Një punë e papaguar e dikurshme.
4. Tersi kur mungon ti
-Fillojnë tani.
5. Bëjnë kurbat me një kub.
-Thirrje Timonieri i Madh.
-Mbyllin një ditar.
6. Mund të jenë unike të tilla
6. Institucione Urbane Rajonale.
-Qenë shkruar publikë dikur.
7. Teke dalte.
-Është kreu i vendit.
8. Mbyllin fushatat.
-Jepen me urdhër.
9. Lau duart me Jezusin.
-Gibson aktor.
10. Janë mendje të ndritura
-Është katastrofa
11. I tillë ishte Martin Luteri.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

P	A	P	A	R	E		T	R	E	V	A			B	D
E	L	E	M	E	N	T	E	T		R		S	A	D	E
P	E	R	A	N	D	O	R		K	A	N	A	L	E	T
	G	E	N	E		M		R	O	S	I	N	A	N	T
K	O	N		A	R		K	O	L	E	K	T	I	V	E
A	R	D	A				S	A	N	K	S	I	O	N	E
L	I	I		R	R	E	T	H	I			S		R	I
L		M		P	E	R	I	O	D	I	K		G		L
A	R	I	E		N	I		W	A	L	T	E	R		I
M	O		M	A	D	A	M	A				K	A	P	A
A	J	E	R		I	L		R	R	E	F	I	M	I	
T	A	L	I	A				E	D	I	T	H	P	I	A

12. Janë produktet me bazë lulesh.
-Rrota pa ekstreme
13. Është stuhi.
-Ukraina në tabela
14. Është cilësi.
-Ivan Lendl.

15. Ripa pa çifte
-Anderson aktor.
16. Si moral.
-Eshtë ai që është tallës.
17. Janë trillet, kapriçiot.
-Është ajo që mban kokën lart.

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGË 19

		2	4		9	7		
5								2
6	7		2		8		1	4
8		4		7		1		3
		1	8		3	2		
3		6		9		4		8
9	1		5		4		3	6
4								1
		3	9		1	5		

PËRGJIGJE

1	3	9	2	7	8	5	6	4
2	7	8	5	6	4	9	1	3
5	6	4	1	9	3	7	8	2
6	8	1	3	5	9	2	4	7
7	9	3	6	4	2	8	5	1
4	2	5	7	8	1	3	9	6
9	4	2	8	1	7	6	3	5
3	1	6	9	2	5	4	7	8
8	5	7	4	3	6	1	2	9

FJALËKRYOI **SPORTIV**

HORIZONTAL

1. Është për medaljen e të parit
2. Nelson portier brazilian.
4. Një legjendë.
6. Fillojnë panikun.
8. Fillojnë kalimin.
9. Është lojtar i Real Madrid.
12. Është bas me katër tela.
15. Numër i shkurtër.
16. Ish-portier i yni.

18. Pak origjinale.
20. Navratilova ish-teniste.
21. Myblin krahun.
22. Fillojnë tatëpjetën.
23. Personazhi në foto.
26. Është vend nisjeje.
28. Kufizojnë elemente.
29. Ylli i anglezëve.
31. Ringo ish-Beatles.
34. Një detar si Durrës.
36. Lëvizja e Ilir Metës.
37. Personazhi në foto.

VERTIKAL

1. Muhammad i boksit
2. Fillojnë daljen
3. Hapen për ajër.
4. Fillojnë matjet.
5. Kështu brohorasin tifozët bardheblu.
6. Skuadër portugeze.
7. Niki ish-pilot.
8. Një brinjë në skuadër.
10. Një skuadër e Pragës.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

	T	A	B	R	P	M	A	R	E	K
	I	L	R	O	C	O	R	I	T	E
	B	E	R	N	A	R	D	E	S	C
	G	S	P	O	R	T	I	V	E	E
B	A	M	A	R	C	E	L	L	O	R
E	R	A	R	T	I	D	O	D	A	K
N	I	S	A	A	O	I	M			
	A		B	A	R	E	N	A		
L	O	R	E	N	Z	O	I	N	S	I
J	U	A	N	C	A	D	R	A	D	O



11. Alessio mesfushor italian.
12. Një enë uji.
13. Ekstremitet në takimin
14. Rastis në kufij.
17. Direkt nga Londra.
18. Janë në gotë.
19. Një mund të jetë shënimi.
20. Një pjesë e marrëzisë.
23. Tri të parat në maratonë.
24. Skuadra e Zidane.
25. Fatih trener.
27. Fillojnë takimin.
29. Qyteti mërg me circuitin.
30. Duilio që që kampion italian i boksit.
31. Festa pa fe.
32. Richard Strauss.
33. Janë në derë.
34. Carlo Verdone.
35. Iniciale të Donadoni-t.

FJALEKËRYQI I KRIPTOGRAFUAR

9	6	3	2	12		2	1	2		8	1	2	
	4		4	8	7	5	2		10	18	6	1	
16	7	11		3	11		11	19	2		5	18	
8	2		3	9	1	6	1	6	20	7	10	6	
4		4	7	1	6	5	2	1	17	5	6		
	10	7	11	6	5	2	4	6	1		1	16	
13	2	4	8	5	6	3	7	1		14	6	18	
	3	2		14	7	3	1		7	11		1	6
12	13		7	10		7	3	10	7	3		10	
4	2	10			3	1	8	2		6	14	7	
2	5	7	2	11	6			1	2	13	7	10	
13	2	11	1	7	11	2	1		⁹ H	² A	¹² P	⁷ I	

PËRGJIGJE

	G	S		P	A	P	A	S		P	O	P	E
R	R	E	P	E						P	I	L	E
P	O	P	U	L	L	O	R	E			L	E	L
	P	A	L	E	O	N	T	O	L	O	G	E	
P	E	T	E	R	P	A	N		L	T		N	
U	A		I	E	R		S	A		M	A		
S	M		E	N	T	E	R		M	P	I		
H	A	L	L	A		T	U		P	A	S	S	
T	A		L		S	T	A		S	M	A	L	T
U	S	T	A		U	P		A	T	L	E	T	
E	H	U		A	T	L	A	S		A	R	E	A
S		A	U	T	O	R		A	R	E	T		

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

Alba MALLTEZI **DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP** ; Aurel PEPA **KRYEREDAKTOR**
 Patricia COSTANTINESCU **ADMINISTRATORE E PËRGJITHSHME**; Admirina PEÇI **KRYEREDAKTORE E "RILINDASI"** ;

LAYOUT DESIGN : Altin ALIAJ, **SHPËRNDARJA:** Spiro MESHINI **CEL:** +355696088847

Redaksia: Rruga "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë Tiranë. **Email:** shqiptaria.com@hotmail.com **Website:** www.shqiptaria.com **Mobile:** +355696060421 Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

Redaksia: Ruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë Tiranë. **E mail:** shqiptarja.com@hotmail.com **Website:** www.shqiptarja.com **Mobile:** +355696060421 Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Ruga 5 Maji, Tiranë

Departamenti i Marketingut: Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419 - marketing@shqiptarja.com

Loris Castriota Skanderbegh, princi që fsheh Foggia

Pasardhësi i heroit kombëtar: Lidhjet Pulja-Shqipëri po forcohen më shumë se kurrë

NGA **SELENE SCINICARIELLO***

Një takim i rastit mes dy gazetarëve këto ditë ka zbuluar se një nga pasardhësit e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut jeton dhe punon në Foggia të Puljes, në Itali. Ai është gazetar, por emri i tij tregon gjithshka: quhet Loris Castriota Skanderbegh dhe nuk e fsheh që rrjedh nga familja e "kryepincit të Arbërit". Sa më poshtë vijon intervista e gazetares Scinicariello me të, që është publikuar në gazetën "Il mattino di Foggia"

Përshëndetje, Loris. Së pari, të falenderoj shumë që vendose të pranosh këtë intervistë. Pasi të takova në Foggia gjatë vizitës me pjesëmarrjen e mediave "Foggia Svelata" (Foggia e zbuluar) dhe pasi zbulova edhe mbiemrin tënd, duke qenë dashamirëse e Ballkanit dhe Shqipërisë, më lindi kuroziteti. Më tregon se çfarë lidhesh ke me heroin shqiptar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu? Në Shqipëri ai është një simbol me të vërtetë i rëndësishëm, apo jo?

Unë jam një pasardhës i drejtpërdrejtë i Gjergjit. Familja ime jeton në Pulja që kur djali i tij erdhi këtu, pas vdekjes së heroit. Kastriotët më parë morën feudet në Monte Sant'Angelo dhe San Giovanni Rotondo, më pas i këmbyen ato me feudet e Galatinas dhe Soletos, në Salento. Që atëherë, familja ime jeton në Lecce. Unë jam këtu pasi babai im, Giorgio, vendosi të martohet me një banorë të Foggia-s, nënën time Adele Berardi.

Çfarë marrëdhëniesh ka me heroit shqiptar dhe Puljas?

Marrëdhëniet historike të Skënderbeut me Puljen janë të rëndësishme, edhe pse këtë e dinë vetëm studiuesit e historisë, shqiptarët dhe banorët e komuniteteve arbëreshe, "koloni" historike italo-shqiptare, që u ngulën në qendër-jug të Italisë shekujt e kaluar dhe ku ruhen kujtesa historike, tra-

ditat, zakonet e vendit të origjinës. Skënderbeu, mirënjohës për ndihmat që i dha mbreti Alfons i Napolit në luftën e tij kundër përpjekjeve otomane për pushtim, mes gushtit të vitit 1461 dhe shkurtit 1462 erdhi personalisht vetë në Pulja për të mbështetur mbretin e ri Ferrante të Aragonës, i cili u ngjit në fron pas vdekjes së babait të tij Alfons, në vitin 1458 dhe po përjetonte vështirësi të mëdha. Në fakt, Ferrante ishte angazhuar në shtypjen e përpjekjes së pushtimit të mbretërisë nga ana e Giovanni-t të Anzhuinëve, që pretendonte fronin dhe kishte bindur të ngriheshin në revoltë edhe shumë feudalë të mëdhenj, që kërkonin rikthimin e sundimit francez. I rrethuar në kështjellën e Barletta-s, mbreti mezi po e mbante fronin. Por Gjergj Kastrioti, duke përfutur nga një armëpushim me sulltanin, erdhi për të kthyer borxhin e nderit që kishte me dinastinë aragoneze dhe, me një grup prej rreth 700 kalorësish dhe një shifër të panjohur këmbësorësh, zbarkoi në Barletta, e çliroi mbretin dhe udhëhoqi disa veprime ushtarake, që përbysin faktikisht fatet e përplasjes, deri në atë pikë, sa e çoi Ferranten drejt fitores më 18 gusht në Troia, provincë e Foggia-s, fitore vendimtare për të ruajtur kontrollin e mbretërisë. Ky ishte një rast për të forcuar lidhjet mes familjes së Kastriotëve dhe Aragonasve. Nuk ishte rastësi që, pasi vdiq Gjergji,

mbreti Ferrante ftoi djalin dhe të venë e tij, Gjon dhe Donika, të transferoheshin në Mbretërinë e Napolit për të mos u bërë viktima të hakmarrjes së sulltanit, që po e përfundonte pushtimin e territorit shqiptar.

A është shumë i madh komuniteti shqiptar në Pulja sot?

Qendrat arbëreshe janë tre, ato të themeluara apo të ripopulluara nga komuniteti historik italo-shqiptar: San Marzano di San Giuseppe (Taranto), Casavecchio di Puglia (Foggia) dhe Chieuti (Foggia). Në total, pak më shumë se 12 mijë banorë dhe jot ë gjithë e flasin gjuhën që është transmetuar gjatë pesë shekujve në ato zona. Sot kemi një problem serioz të ruajtjes së gjuhës, traditave dhe identitetit kulturor: një trashëgimi historike dhe folklorike, që rrezikon të zhduket përballë standardizimit të njohurive të globalizuara dhe nga zhdukja graduale e zakonit të arbëreshëve që të martoheshin vetëm mes tyre dhe duke transmetuar doke dhe gjuhën në jetën e përditshme.

Sot ti jeton në Foggia, je gazetar dhe merresh me sektorin e komunikimit tek kryebashkiaku, por vetëm me këtë. Gjatë vizitës mediatike "Foggia Svelata" na shoqërovenë Muzeume Qytetit dhe nuk fshehe dashurinë për atë vend dhe për qytetin. Mendon që Foggia ka ende një potencial ende të pasprehur në nivel turistik? A ka ndonjë gjë që mund të bëhet më shumë për të treguar këtë qytet dhe për të tërhequr vizitorë nga e gjithë Italia dhe, pse jo, nga e gjithë bota?

Sigurisht që ka. Foggia ka shumë aspekte të panjohura edhe për vetë banorët e saj, që kanë mbajtur një qendrim gati mosbesues ndaj rëndësisë dhe bukurisë historiko-artistike të qytetit të tyre. Është rezultat i ngjarjeve negative që kanë ndodhur në Foggia ndër vite, si tërmeti shkatërrimtar i vitit 1731 apo bombardimet e aleatëve në verën e vitit 1943. Megjithatë, pavarësisht shkatërrimeve të pësura, Foggia ka ruajtur



shumë dëshmi interesante të së kaluarës, që do t'u pëlqenin edhe turistëve "më të vështirë": e rëndësishme është të kenë një guidë kompetent, të përgatitur dhe të apasionuar.

Në aspektin e "të treguarit të qytetit", administrata bashkiake ka bërë shumë "indirekt", duke organizuar evente tërheqëse si "Libando", festivali i ushqimit në rrugë, apo "Giordano in Jazz", takim vjetor me koncertet e muzikantëve më të mëdhenj të këtij zhanri, për të tërhequr vizitorë që të dashurohen edhe me Foggia-n apo që të ndalojnë ose të kthehen këtu për ta njohur më mirë. Por sa i takon Shqipërisë, si e shikon zhvillimin e turizmit këto vitet e fundit?

Në Vendin e Shqiponjave po fillojnë të vijnë flukset e mëdha të turizmit, edhe atij ndërkombëtar, sidomos gjatë verës dhe sidomos në zonat bregdetare të qendrës dhe të jugut të Shqipërisë: kjo është për shkak të plazheve të pandotur, strukturave akomoduese që përmirësohen gjithnjë e më shumë dhe çmimeve me të vërtetë konkurruese. Por kur turistët të zbulojnë se ka gjëra për t'u vizituar edhe në brendësi, qoftë në aspektin e pejsazhit, ashtu edhe të kulturës, Shqipëria do të bëhet një destinacion i dorës së parë për ata që e duan të bukurën në çdo cep të planetit!

Një pyetje të fundit, sipas teje, ka një lidhje apo diçka që bashkon Puljen me Shqipërinë?

Ka një lidhje të fuqishme, që nuk ka të bëjë vetëm me "gjerësinë gjeografike" në të cilën ndodhen të dy territoret: jemi popuj mesdhetarë dhe ndajmë zakone e mënyra jetese, por edhe pejsazhe të ngjashëm. Do të shtoja se puljezët e sotëm kanë prejardhje nga fiset ilire, që emigruan në jug të Italisë, në Pulja, duke filluar nga mijëvjeçari i parë para Krishtit: Daunët (provincia aktuale e Foggia-s), Peucetët (në Puljen aktuale qendrore) dhe Mesapët (në Salento). Të gjithë ata quheshin Japigë dhe puljezët u detyrohen atyre një pjesë të rëndësishme të kulturës së tyre stërgjyshore. Kjo lidhje u përtëri nga migrimet e shekullit të 15-të dhe u mbajt gjallë nga komunitet arbëreshe, por "u rigjallërua" nga mbërritja e imigrantëve të rinj shqiptarë të viteve '90 dhe sot ka fituar një forcë të re në sajë të intensifikimit të marrëdhënieve institucionale ndërmjet Puljes dhe Shqipërisë dhe për faktin se porti dhe aeroporti i Barit janë pika mbërritjeje dhe nisjeje mes dy territoreve. Në thelb, kjo është një lidhje që nuk është zhdukur kurrë dhe që do të vazhdojë të forcohet në të ardhmen.

*) Gazetare e "Il mattino di Foggia"

